



**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME  
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE**

---



**RAPORT I INSPEKTIMIT  
"MENAXHIMI I FLOTËS SË AUTOMJETEVE DHE PAJISJEVE  
PËRCJELLËSE"**

**Nr. 7/2020**

**Prishtinë, 31 janar 2021**

## Informata të përgjithshme

---

<b>Titulli</b>	Raport i inspektimit Menaxhimi i flotës së automjeteve dhe pajisjeve përcjellëse
<b>Data e përgatitjes</b>	31 janar 2021
<b>Përgatitur nga</b>	Servet Tasholli, udhëheqës i ekipit të inspektimit, Leonora Krasniqi, inspektore, Kushtrim Jonuzi, inspektor
<b>Mbikëqyrur nga</b>	Illir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
<b>Mbështetur nga</b>	Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
<b>Dorëzuar nga</b>	Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
<b>Miratuar nga</b>	Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv, Inspektorati Policor i Kosovës
<b>Data e miratimit</b>	31 janar 2021

### 1. Përmbledhja ekzekutive

- 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....(4-5)
- 1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....(5-5)

### 2. Hyrje

- 2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit.....(6-6)
- 2.2. Qëllimi.....(6-6)
- 2.3. Objekti.....(6-6)
- 2.4. Subjekti.....(6-6)
- 2.5. Objektivat e inspektimit.....(7-7)
- 2.6. Rëndësia e inspektimit.....(7-7)
- 2.7. Metodologjia e inspektimit.....(7-8)
- 2.8. Periudha e kryerjes së inspektimit.....(8-8)
- 2.9. Periudha e mbulimit të inspektimit.....(8-8)
- 2.10. Drejtimet e inspektimit.....(8-8)
- 2.11. Kriteret e vlerësimit.....(8-8)
- 2.12. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave.....(8-8)

### 3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet

- 3.1. Gjendja teknike e automjeteve policore.....(9-11)
- 3.2. Përdorimi, shpërndarja dhe kontrolli i automjeteve.....(11-14)
- 3.3. Kostot dhe mirëmbajtja.....(14-17)
- 3.4. Sigurimet dhe regjistrimet e automjeteve.....(17-18)
- 3.5. Aksidentet e trafikut me përfshirje të automjeteve policore.....(19-22)
- 3.6. Kushtet teknike të automjeteve për pjesëmarrje në qarkullim.....(22-23)

### 4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

- 4.1. Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....(24-28)

Shtojcat

## **1. Përmbledhja ekzekutive**

---

### **1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit**

1.1.1. Automjetet janë një aset shumë i rëndësishëm për Policinë dhe varësisht nga gjendja dhe mirëmbajtja e tyre, varet edhe efikasiteti dhe performanca e njësive policore në përmbushje të mandatit ligjor. Sipas matjeve dhe vlerësimeve të bëra nga IPK-ja, Policia vazhdon të ketë një park automjetesh të vjetëruar dhe krahasuar me matjet e para tre viteve, ka vazhduar të shtyhet edhe më tutje mosha e saj. Inspektimi i kryer në gjithsej 16 stacione policore ka dëshmuar se gjendja teknike e automjeteve vazhdon të jetë jo e kënaqshme. Plani i zëvendësimit të automjeteve që ka për qëllim përmirësimin e gjendjes me automjete, këto tre vite nuk ka ndjekur ritmin e nevojshëm dhe shihet se furnizimet e planifikuara nuk realizohen për shkak të ndikimit të disa faktorëve. Janë për t'u çmuar nismat e realizuara për tjetërsimin e automjeteve, në drejtim të freskimit të Parkut, por edhe shmangies së krijimit të shpenzimeve të panevojshme në revitalizimin e tyre. Parku është liruar nga një pjesë e madhe e automjeteve, të cilat edhe janë hequr nga Regjistri i Pasurive.

1.1.2. Inspektorët kanë vërejtur se ka angazhime dhe aktivitete në stacione për të mbikëqyrur dhe kontrolluar gjendjen e automjeteve dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre. Ka dëshmi mbi kontrollin e drejtuesve dhe mbikëqyrësve në kontrollin e gjendjes, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit racional të automjeteve. Kontrollin ditore para përdorimit nuk aplikohen rregullisht nga përdoruesit dhe ato neglizhohen. Formulari i përdorimit të automjetit (fletëudhëtimi) është hasur duke u përdorur në të gjitha automjetet e inspektuara dhe brenda tyre figurojnë informatat e nevojshme. Krahasuar me tre vite më parë, vërehet kujdes i shtuar në mbajtjen e pastërt të automjeteve dhe çmohet angazhimi i stacioneve në mbajtjen e higjienës brenda tyre. Inspektimi i realizuar pasqyron se stacionet nuk kanë automjete të mjaftueshme për të realizuar nevojat dhe kërkesat e tyre dhe kjo shtrun nevojën e analizimit të gjendjes aktuale, shpërndarjes më adekuate dhe ngritjes së kapaciteteve aktive. Janë identifikuar edhe gjatë këtij inspektimi, raste të mosdeklarimit me kohë të defekteve duke rrezikuar ngritjen e kostove të mirëmbajtjes. Serviset rajonale vazhdojnë të mos jenë funksionale në masën e duhur në mungesë kapacitetesh të burimeve njerëzore, kurse mirëmbajtjet e lehta po vazhdojnë të kryhen nga ekipet mobile të Flotës Operative.

1.1.3. Në procedurën e mirëmbajtjes brenda Njesisë së Autoservisit nuk janë hasur dobësi lidhur me pranimin e automjeteve, caktimin e mekanikëve, hapjes së kartelave të punës, caktimit të komisionit inspektues, evidentimit të prishjeve, kontaktimit të deposë lidhur me pjesët, procedimin e automjeteve tek operatorët e kontraktuar, kontrollimit të automjetit pas kthimit, mbylljes së kartelës dhe dorëzimit të automjeteve. Kostot mbi shërbimet e operatorëve të kontraktuar shënojnë nivel shumë më të ulët krahasuar me disa vite më herët. Janë reduktuar vonesat në tërheqjen me kohë të automjeteve pas daljes nga procesi i mirëmbajtjes. Flota Operative ka në funksion Sistemin PRIMS, i cili në kohën e inspektimit ka pasur disa të meta dhe sanimi i tyre do ta bënte atë më funksional dhe në shërbim të kërkesave të strukturës policore. Dobësitë e PRIMS kanë vështirësuar gjenerimin e disa të dhënave mbi efikasitetin dhe performancën në procesin e mirëmbajtjes. Lidhur me kthimin e pjesëve të ndërruara në programet e mirëmbajtjes mbahet evidencë e veçantë, duke minimizuar mundësinë e keqpërdorimit të tyre. Depo e Flotës Operative mban evidencë të dyfishtë mbi stokun e pjesëve rezervë dhe mbi pranimin e tyre mbahen regjistrat fizik të hyrje - daljeve dhe regjistri elektronik. Kostot në disa kategori shpenzimesh janë ulur krahasuar me disa vite më parë (gomat, pjesët rezervë dhe shërbimet kontraktuese), duke ngritë shkallën e ekonomizimit.

1.1.4. Me Procedurën Standarde të Operimit për Flotën Operative, përgjegjësia për njoftimin e zyrtarëve të mirëmbajtjes në stacione është hequr nga Zyra e Regjistrimeve dhe Sigurimeve dhe tanimë zyrtarët e tillë janë përgjegjës për të kryer me kohë kontrollet teknike dhe për të dorëzuar certifikatat tek Zyra e Regjistrimeve dhe Sigurimeve. Nga verifikimi i librezave të qarkullimit nga mostra 100%, është identifikuar se rreth 40% e automjeteve policore, regjistrimin e fundit e kanë kryer me vonesë dhe këto janë ndikuar në masë të madhe nga dështimi i procedurave në arritjen e kontratave për shërbime të sigurimit. Po ashtu, inspektimi ka vënë në pah se shumë nga automjetet gjatë periudhës sa kanë qenë të paregjistruara, kanë lëvizur dhe kjo është identifikuar nga një mostër prej 180 automjeteve të paregjistruara, ku 90 prej tyre vërehet se kanë lëvizur pa regjistrim.

1.1.5. Vitet 2017 e 2018 kanë shënuar numrin më të lartë të aksidenteve/incidenteve me përfshirje të automjeteve policore, të ndodhura në tetë (8) vitet e fundit. Në vitin 2019, lakorja e trendit të aksidenteve jep shenja pozitive drejt uljes së numrit të tyre. Punonjësit policor konsiderohen fajtor të aksidenteve në afërsisht 50% të rasteve dhe sipas të dhënave të Zyrës së Aksidenteve, nga 65% sa ishte në vitin 2017, bie në 58% në vitet 2018 dhe 2019, përqindja e rasteve të raportuara me vonesë të aksidenteve/incidenteve. Përqindja në rënie është inkurajuese, por nevojitet angazhim dhe seriozitet në raportimin me kohë të aksidenteve dhe incidenteve brenda afatit dhjetë ditor nga ndodhja e tyre. Faktori njeri vlerësohet të jetë shkaktari më i shpeshtë i aksidenteve dhe incidenteve dhe në tre vitet e fundit aksidentet më të shpeshta vlerësohet të kenë ardhur nga shkeljet e neneve 41 (veprimet me mjetin motorik), 53 (përshtatja e shpejtësisë) e 52 (lëvizja prapa) të ligjit në fushën e trafikut rrugor. Inspektimi i dosjeve me fajësi të zyrtarëve policor, ka gjetur se brenda tyre nuk janë duke u bashkëngjitur inicimet e brendshme disiplinore dhe nga një mostër prej 100% që lidhen me 469 raste të aksidenteve dhe incidenteve në tre vitet e fundit, diku 81% e dosjeve nuk kanë të bashkëngjitur inicimet e tilla. Nga një verifikim rastësor janë hasur raste të aksidenteve/incidenteve ku fajtor vlerësohen të jenë zyrtarët policor, dhe për të njëjtit nuk inicohen procedurat e parapara.

1.1.6. Nga verifikimi i pajisjeve rezervë apo shtesë të automjeteve dhe dokumenteve që duhet t'i kenë me vete ngasësit e automjeteve, vërehet se ka shumë mungesa të evidentuara, bazuar në Ligjin nr. 05/L-088 për rregullat në trafikun rrugor dhe udhëzimet administrative të hartuara nga Ministria e Infrastrukturës. Struktura policore duhet ngrisë nivelin e sigurisë për të përmbushur rregullat për pjesëmarrje në komunikacion, por duhet të krijoj kushte që zyrtarët e saj të mos bëhen shkelës potencial të rregullave, për të cilat shpesh gjobiten pjesëmarrësit në trafik. Nga pajisjet rezervë apo shtesë, në automjete më tepër vërehen mungesa të aparateve për fikje të zjarrit, kutisë së ndihmës së parë, dritave rezervë, mjetit për tërheqje në rast defekti dhe jelekëve reflektues. Kurse sa i përket dokumenteve, janë evidentuar mungesa të konsiderueshme të certifikatave të regjistrimit, polisave të sigurimit dhe raporteve evropiane të aksidenteve.

## **1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve**

1.2.1. Nga inspektimi i kryer ka rezultuar se nga 12 rekomandime të lëna nga inspektimi i kaluar (inspektimi nr. 1/2017), dy (2) prej tyre janë përmbushur plotësisht, një (1) prej është përmbushur përgjithësisht (në masë të madhe), gjashtë (6) janë përmbushur pjesërisht, dy (2) nuk janë përmbushur dhe një (1) nuk është vlerësuar (*për më tepër referoju shtojcës 1*).

## **2. Hyrje**

---

### **2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit**

2.1.1. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, IPK-ja ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në Polici, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështetë Policinë për të siguruar një shërbim profesional, demokratik dhe të përgjegjshëm. Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta i Departamentit të Inspektimit të IPK-së (2020) ka përfshirë kryerjen e inspektimeve në disa fusha të menaxhimit, përfshirë edhe atë të flotës së automjeteve dhe pajisjeve përcjellëse. Inspektimi i kësaj fushe menaxheriale paraqet një fushë me interes për IPK-në, me qëllim që të vlerësojë nëse Policia ka kapacitete të mjaftueshme teknike dhe njerëzore për të kryer detyrat në raport me përgjegjësitë e përcaktuara. Është me rëndësi të konstatohet se menaxhimi i flotës së automjeteve policore po ndikon në përmbushjen me sukses të objektivave të vëna nga Policia. Kjo fushë bartë risk për menaxhmentin përshkak të përdorimit të automjeteve, të përcjellur me një kosto të lartë dhe paraqet një nga investimet më të kushtueshme të organizatës policore. Duke konsideruar se inspektimi paraqet një instrument të suksesshëm për të vlerësuar trajtimin e kësaj fushe, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së më 3 shkurt 2020 mbi bazën e Programit të punës inspektuese, ka iniciuar një inspektim për vlerësuar performancën policore në këtë fushë të menaxhimit. Inicimi i inspektimit është ndikuar edhe nga nevoja që Policia të sigurohet se këto asete janë të kontrolluara, të përdorura dhe të ruajtura në mënyrën e duhur. IPK është interesuar të rishikojë edhe nivelin e përmbushjes së rekomandimeve nga inspektimi i kaluar, të realizuar në këtë fushë, të pasqyruara në Raportin e inspektimit nr. 01/2017, të datës 25.09.2017.

### **2.2. Qëllimi i inspektimit**

2.2.1. Qëllimi i këtij inspektimi ka qenë:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret, si dhe parimet dhe procedurat policore përkatëse zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet;
- Që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat;
- Që të jepet opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me menaxhimin e automjeteve;
- Që të parandalojë shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë punës në fushën përkatëse;
- Që të identifikojë mangësitë - dobësitë dhe rekomandoj masa për funksionim më të mirë.

### **2.3. Objekti i inspektimit**

2.3.1. Në këtë inspektim të rregullt është vlerësuar kryerja e detyrave në fushën e menaxhimit të flotës së automjeteve dhe pajisjeve përcjellëse.

### **2.4. Subjekti i inspektimit**

2.4.1. Inspektimi është përqendruar në Flotën Operative në kuadër të Drejtorisë së Logjistikës, si dhe në sektorët e administratës së stacioneve policore.

## **2.5. Objektivat e inspektimit**

### **2.5.1. Objektivat që synon t'i arrijë ky inspektim janë:**

- Të analizohet dhe përcaktohet gjendja teknike e automjeteve policore, përfshirë koston e tyre përgjatë ciklit jetësor të tyre;
- Të analizohet dhe vlerësohet respektimi i procedurave gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe servisimit të automjeteve;
- Të analizohen dhe nxirren treguesit e efikasitetit të shërbimeve të mirëmbajtjes dhe të servisimit të automjeteve;
- Të vlerësohet respektimi i procedurave dhe afateve kohore lidhur me regjistrimin dhe sigurimin e automjeteve;
- Të vlerësohet niveli i pajimit të automjeteve policore me pajisjet e nevojshme, si dhe kujdesi ndaj tyre;
- Të verifikohet disponueshmëria e pjesëve rezervë dhe përputhshmëria e gjendjes së stokut me evidencat në Depon e Flotës Operative;
- Të vlerësohet përmbushja e rekomandimeve të dhëna nga inspektimet e kaluara.

## **2.6. Rëndësia e inspektimit**

### **2.6.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:**

- Ushtrimin e një kontrolli më efikas për të siguruar shkallë të lartë të transparencës, ekonomizimit, efikasitetit dhe leverdisë ekonomike të shfrytëzimit të automjeteve;
- Ngritjen e përgjegjësisë së punonjësve në përdorimin efikas dhe ruajtjen e automjeteve;
- Ngritjen e vetëdijes policore për të ndikuar në minimizimin e rasteve, kur automjetet shfrytëzohen në mënyrën të papërgjegjshme, joracionale dhe jo të duhur;
- Ngritjen e besimit mbi shfrytëzimin e duhur të mjeteve të siguruar nga taksapaguesit.

## **2.7. Metodologjia e inspektimit**

### **2.7.1. Gjatë inspektimit:**

- a) Janë zhvilluar takime-intervista me 21 drejtues, punonjës e bartës funksionesh, përfshirë: Drejtorin e Departamentit për Shërbime Mbështetëse, komandantët e stacioneve policore, Udhëheqësin e Flotës Operative, Udhëheqësin e Njesisë së Autoservisit, Zyrтарin e Zyrës së Sigurimeve dhe Regjistrimeve dhe Zyrтарin e Zyrës së Aksidenteve;
- b) Janë kryer inspektime - kontrole të: procesit të mirëmbajtjes së automjeteve në kuadër të Flotës Operative, gjendjes teknike dhe përkujdesjes ndaj automjeteve policore, dosjeve të aksidenteve, evidencave të stoqeve të pjesëve rezervë në Depo dhe lejeve të qarkullimit të automjeteve policore;
- c) Janë plotësuar formularët e inspektimit për të vlerësuar: pajisjen e automjeteve policore me pajisjet dhe dokumentet e nevojshme, respektimin e procedurave të mirëmbajtjes së automjeteve policore nga personeli i Flotës Operative, mbajtjen e dosjeve të aksidenteve, respektimin e afateve mbi regjistrimin e automjeteve;
- d) Janë marrë dokumente të shkruara, si: raporte vjetore të punës, dëshmi mbi kapacitetet, dëshmi mbi automjetet dhe historikun, kostot e mirëmbajtjes, raportit mbi automjetet e tjetërsuara, dëshmi mbi proceset e vlerësimit të automjeteve për shitje, dëshmitë e

shpërndarjes së automjeteve, raportet e mirëmbajtjes, kopjet e faturave të shërbimeve të mirëmbajtjes tek serviset e autorizuara, kopjet e lejeve të qarkullimit të automjeteve, dëshmi mbi aksidentet dhe incidentet, raportet e stacioneve me të dhëna mbi numrin e automjeteve, raporte mbi gjendjen e stokut në Depo, etj.

## **2.8. Periudha e kryerjes së inspektimit**

2.8.1. Bazuar në Programin e punës inspektuese, inspektimi ka filluar më 12.02.2020 dhe është planifikuar të përfundojë më 13.03.2020, por përshkak të rrethanave të krijuara nga pandemia me Covid-19, faza e punës në terren është prolonguar dhe ka përfunduar më 12.06.2020.

## **2.9. Periudha e mbulimit të inspektimit**

2.9.1. Inspektimi është përqendruar në vlerësimin e kryerjes së detyrave policore gjatë periudhës tre vjeçare (2017-2019) dhe gjendjen aktuale të fushës së menaxhimit të flotës së automjeteve.

## **2.10. Drejtimit e inspektimit**

2.10.1. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Gjendja teknike e automjeteve policore (funktionaliteti);
- Përdorimi, shpërndarja dhe kontrolli i automjeteve;
- Mirëmbajtja dhe kostot;
- Sigurimet dhe regjistrimet e automjeteve;
- Aksidentet e trafikut me përfshirje të automjeteve policore;
- Kushtet teknike të automjeteve për pjesëmarrje në qarkullim.

## **2.11. Kriteret (standardet) e vlerësimit**

2.11.1. Dokumentet në vijim janë baza, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave:

- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë;
- Ligji nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor;
- Ligji nr. 02/L-070 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor;
- Rregullorja për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës;
- Udhëzimi Administrativ nr. 02/2008 për Përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Kosovës;
- Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 01/2018 për Regjistrimin e mjeteve;
- Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 01/2018 për Regjistrimin e mjeteve;
- Udhëzimi Administrativ (MI) nr. 04-2016 për kontrollimin teknik të automjeteve;
- Udhëzimi Administrativ (MI) nr. 02-2017 për Pajisje dimërore
- Doracaku i Parimeve dhe procedurave të Policisë;
- Procedurat Standarde të Operimit për Flotën Operative (DL-03, datë 22.12.2017).

## **2.12. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave**

2.12.1. IPK-ja vlerëson se gjatë punës në terren dhe pasqyrimin të gjetjeve në raportin e zgjeruar të inspektimit, nuk ka hasur në ndonjë vështirësi që do të ndikonte në përmbushjen me sukses të objektivave të vëna me Programin e punës inspektuese.



### 3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet

#### 3.1. Gjendja teknike e automjeteve (funktionaliteti)

3.1.1. Sipas të dhënave të fundvitit 2019, Parku i automjeteve përbëhet nga 1.402 automjete, të prodhuara nga 34 prodhues dhe të ndara në 102 modele. Mosha e automjeteve (vjetërsia) fillon nga viti 1982-2019. Për detaje më të hollësishme sipas grup-moshave, pasqyrohet se 75% e automjeteve është mbi shtatë (7) vite, ndërsa mosha e përgjithshme mesatare e automjeteve është rreth 11 vite. Nëse krahasojmë moshën e tanishme mesatare të të gjitha automjeteve, me atë të para tre (3) viteve kur është bërë inspektimi i fundit në këtë fushë, del se është shtyrë mosha mesatare nga 10 vite sa ishte më parë, në 11 vite aktualisht<sup>1</sup>. Veç këtij indikator shihet se Policia ka në kuadër të saj edhe numër të madh automjeteve, që kanë kaluar shumë kilometra. Nga 1.402 automjete të evidentuara në fund të vitit 2019<sup>2</sup>, 972 prej tyre janë në funksion të plotë (69.3%), derisa 273 automjete janë të përfshirë në proces të tjetërsimit (19.5%) dhe 157 të tjera në proces të mirëmbajtjes apo në pritje për riparim (11.2%). Nëse analizojmë lëvizjen e numrit të automjeteve sipas grup-moshave, kemi ngritje të numrit të tyre brenda kategorisë 0-7 vite për 3.3%. Kemi ulje të numrit të automjeteve brenda kategorisë 7-14 për 22.8%. Sinjal negativ për vjetërsinë e Parkut pasqyron kategoria e grup-moshës nga 14-21 vjet, ku kemi ngritje të numrit të tyre përbrenda kësaj grup-moshe për 19.8% krahasuar me tre vite më parë. Duke parë këta parametra, vjetërsia e Parkut është e evidente dhe si proces ka një shkallë të rritjes enorme. Politikat zhvillimore strategjike ende nuk kanë trajtuar në masën e duhur problemet, me të cilat është ballafaquar Parku. Policia nuk ka strategji adekuate për funksionimin dhe mbajtjen e Parkut, që t'iu jep përgjigje problemeve që atakojnë mirëfunksionimin. Trajtimi i duhur i temave lidhur me funksionimin e Parkut, kërkon nevojën për mobilizim të nivelit strategjik në nxjerrjen e Strategjisë për të siguruar Park funksional, por edhe atij operativ në mbajtjen efikase, racionale dhe ekonomike të funksioneve që lidhen me Parkun (blerje, mirëmbajtje e operim).

**Tabela nr. 1 - Të dhëna mbi vjetërsinë e Parkut, grup-moshat dhe krahasimi 2017/2019**

Grup mosha (vite)		Numri i automjeteve në vitin 2017	% (2017)	Numri i automjeteve në vitin 2019	% (2019)
Prej	Deri				
0	7	333	21.6	349	24.9
7	14	1.051	67.9	632	45.1
14	21	125	8.1	391	27.9
21	28	9	0.6	17	1.2
28	35	28	1.8	13	0.9
		<b>1.546</b>	<b>100%</b>	<b>1.402</b>	<b>100%</b>

3.1.2. Inspektorët janë interesuar të dijnë për gjendjen teknike të automjeteve policore dhe kanë inspektuar 62 automjete funksionale, që kanë qenë prezent në 16 stacione policore të inspektuara. Pas kontrollit të kryer është konstatuar se prej 62 automjeteve të kontrolluara, 21 prej tyre (33.9%) kanë rezultuar me probleme të natyrës teknike, derisa 41 të tjera (66.1%) nuk kanë pasur probleme teknike që mund të vërehen vizualisht. Tek automjetet policore që janë vlerësuar me gjendje jo të mirë teknike, janë vërejtur dëmtime të karroserisë dhe dritave, mosfunksionim i klimave, probleme të sinjalizimit dhe alarmit, probleme të sistemit të frenimit dhe marshit, mungesë të logos policore,

<sup>1</sup> Tabela e automjeteve policore sipas vitit të prodhimit (Flota).

<sup>2</sup> Në këtë numër përfshihen automjetet, rimorkiot, motoçikletat dhe skuterët.

mungesë të radiove të komunikimit dhe dëmtime të ulëseve apo rripit të sigurisë, etj. Doracaku i Parimeve e Procedurave të Policisë, në Parimin P-10.01, kapitulli I (Procedurat e mirëmbajtjes së automjeteve) ka përcaktuar përgjegjësitë dhe obligimet që dalin mbi mirëmbajtjen e automjeteve. Gjendja e papranueshme teknike e automjeteve është rezultat i neglizhencës së punonjësve policor, zyrtarëve për mirëmbajtjen e automjeteve në kuadër të stacioneve dhe mbikëqyrësve. Gjendja jo e mirë teknike e automjeteve mund të ketë shumë efekte negative, por më kryesore konsiderohen probabiliteti për të rrezikuar drejtuesit e mjeteve në trafik dhe rënia e imazhit përshkak të pamjes së papranueshme të tyre gjatë ekspozimit të tyre në rrugë. Edhe herën e fundit kur është inspektuar kjo fushë, inspektorët kanë hasur në një gjendje të papranueshme të automjeteve të inspektuara.

#### **Rekomandimi nr. 1**

*IPK-ja u rekomandon të gjithë mbikëqyrësve, zyrtarëve të mirëmbajtjes dhe përdoruesve të automjeteve zyrtare në stacione policore, që gjithëherë të ndërmarrin veprimet e nevojshme rreth deklarimit dhe procedimit të automjeteve zyrtare në procedurë të mirëmbajtjes, kur vërejnë se gjendja teknike e tyre nuk përkon me standardin e kërkuar, me qëllim të aftësisimit të tyre operativ, ofrimit të sigurisë në rrugë dhe ngritjes së imazhit policor.*

3.1.3. Policia kohë më parë ka projektuar një Analizë<sup>3</sup> me një vlerësim për nevojat me automjete, për funksionimin normal të saj. Analiza ka marrë parasysh gjendjen e përgjithshme të automjeteve, menaxhimin, nevojat për funksionim të duhur të Parkut, nevojat në nxjerrjen e planeve për mirëfunksionim dhe planifikimin financiar për të ardhmen. Është përdorur formula për vendosjen e një optimumi të nevojshëm automjetesh, duke marrë parasysh aktivitetet patrulluese/hetimore/administrative, praktikat më të mira dhe nevojat. Bazuar në politikat e zëvendësimit të automjeteve, Analiza e menaxhmentit të Flotës potencon nevojën e zëvendësimit të automjeteve për çdo vit me nga 137 sosh, duke ditur se çdo vit tjetërsohen po aq, konform kritereve të Rregullores (MF) nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo-financiare në Organizata Buxhetore. Respektimi i Planit të zëvendësimit për vitet e fundit nuk është mbështetur me veprime konkrete, ngase freskimi i Parkut me automjete të reja nuk përcjellë trendin e nevojshëm sipas formulës së zëvendësimit, për shkak të ndikimit të disa faktorëve, përfshirë kufizimet buxhetore dhe procedurat e prokurimit. Kërkesa e Flotës për automjete, e dalur nga Analiza për furnizime të përvjetshme me nga 137 automjete të reja për secilin nga katër vitet që janë pjesë e saj, mbetet e paarritshme, meqë në vitin 2017 janë blerë 60 automjete (43.8%), në vitin 2018 janë blerë 58 automjete (42.3%), kurse në vitin 2019 janë blerë 37 sosh (27%). Trendet aktuale tregojnë se Policia rrezikon të përtrijë Parkun e automjeteve, ka për pasojë vjetërsimin dhe funksionimin jo të duhur të saj. Nga 411 automjete sa ka paraparë kërkesa e dalur nga Analiza për automjete, në tre vitet e fundit janë furnizuar vetëm 155 sosh, duke arritur kuotën në 37.7% të realizimit të kërkesës së përgjithshme.

#### **Rekomandimi nr. 2**

*IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që në koordinim me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, të angazhohet në përmbushjen e nevojave si rezultat i politikës së zëvendësimit të automjeteve, në mënyrë që të realizohet formula që siguron optimumin e numrit të automjeteve për nevoja operative, ngase trendi aktual i furnizimit me automjete të reja zyrtare nuk garanton përtëritjen e Parkut, por përkundrazi ngritë moshën mesatare të automjeteve.*

<sup>3</sup> Drejtoria e Logjistikës, *Projekt analizë mbi vlerësimin e nevojave për automjete për PK-në (2016-2020)*.

3.1.4. Viteve të fundit janë hasur në nisma për largimin e mjeteve nga fondi i Parkut. Shumë nga automjetet kanë qenë të stërvjetëruara, duke tejkaluar kufinj të mirëmbajtjes në raport me koston blerëse. Kjo gjendje ndikon në rënien e funksionalitetit të Parkut, krijon shpenzime operative të mirëmbajtjes dhe krijon humbje kohe në proceset e mirëmbajtjes. Largimi i këtyre aseteve përmes tjetërsimit është i ligjshëm dhe mëse i domosdoshëm. Kur thuhet kjo, IPK-ja bazohet në moshën e shtyrë të automjeteve dhe kilometrat e kaluara. Për të mënjanuar kostot e larta të mirëmbajtjes, organizata ka inicuar disa procese të tjetërsimit të automjeteve. Në vitin 2018 janë tjetërsuar 126 automjete, në vitin 2019 janë tjetërsuar 328 automjete, kurse sipas informacioneve të fundit që ka siguruar IPK-ja, në vitin 2020 janë inicuar edhe tre procese për tjetërsimin e automjeteve, duke arritur numrin në gjithsej 388 automjete (një prej këtyre tre proceseve ende nuk ka përfunduar dhe përmban kërkesë për tjetërsim të 73 automjeteve policore). IPK-ja është siguruar se lidhur me të gjitha këto procese janë përfillur procedurat e rregullta siç parashihen me Rregulloren në fuqi, ku janë përfshirë ekipet e ekspertëve të Flotës Operative, komisionet e vlerësimit të pasurive dhe lidhur me tjetërsimin e tyre është marrë aprovimi paraprak nga Ministria përkatëse. Sipas Sektorit të Aseteve të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, për katër nga pesë proceset e tjetërsimit, janë liruar automjetet nga Regjistri i Pasurive, derisa për njërin prej proceseve ende nuk ka përfunduar kjo fazë. IPK-ja çmon punën e bërë të strukturës policore në përmbushjen e rekomandimit të dhënë nga IPK-ja për shtyrjen para të procesit të tjetërsimit, por inkurajon atë të vazhdojë procesin edhe me largimin e këtyre aseteve nga Regjistri i Pasurive, meqë deri në zhvillimin e inspektimit, një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur për njërin prej proceseve. Tjetërsimi i automjeteve freskon Parkun dhe eliminon shpenzimet e panevojshme në këto pasuri.

## 3.2. Përdorimi, shpërndarja dhe kontrolli i automjeteve

3.2.1. Udhëzimi Administrativ nr. 03/2008 për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Kosovës në nenin 6, paragrafi 6.4, si dhe nenin 7, paragrafi 7.2 ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë në kontrollimin e automjeteve para përdorimit. Po ashtu, edhe Doracaku i Parimeve dhe Procedurave, në Parimin P-10.01 që ka të bëjë me shfrytëzimin e automjeteve, ka përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat e mbikëqyrësve dhe përdoruesve të automjeteve në mirëmbajtjen ditore sipas formularit të listës së verifikimit të automjetit. Aplikimi i kontrolleve apo inspektimeve të automjeteve para përdorimit është duke u aplikuar më kënaqshëm se në të kaluarën, por jo edhe rregullisht çdo ditë nga një numër stacionesh policore. Nga gjithsej 62 automjete të inspektuara, në 15 prej tyre (24%) nuk është hasur në zbatim të plotësisht të formularit të kontrollit ditor. Kontrollat javore janë më të rregullta dhe evidente në të gjitha stacionet e inspektuara. Stacionet praktikojnë edhe kontrollet e jashtëzakonshme, të kohëpaskohshme. Në rastet e kontrollit të automjeteve përdoren formularë të ndryshëm. Mosaplikimi i rregullt i kontrollimit ditor të automjeteve në një numër stacionesh rezulton nga neglizhenca e përdoruesve dhe tendenca e tyre për të konsideruar këtë aktivitet si ngarkesë dhe rutinë në raport me angazhimet operative. Nevojitet të aplikohet formulari standard i kontrollimit, bazuar në dokumentet ligjore në fuqi, meqë sipas inspektimit përdoren formularë të ndryshëm në përmbajtje.

### **Rekomandimi nr. 3**

*IPK-ja i rekomandon komandantëve të stacioneve policore që në bashkëpunim me zyrtarët e mirëmbajtjes, të organizojnë kontrolle të shpeshta në drejtim të sigurimit se automjetet policore përdoren dhe kontrollohen nga përdoruesit konform rregullave dhe procedurave në fuqi mbi menaxhimin e automjeteve.*

3.2.2. Udhëzimi Administrativ nr. 02/2008 për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Kosovës, në nenin 6, paragrafi 6.3, ka përcaktuar obligimin që ka çdo drejtues i automjetit zyrtar që në Fletëudhëtim të shënojë numrin e kilometrave të automjetit në momentin e nisjes, destinacionin e udhëtimit, qëllimin e udhëtimit, numrin e kilometrave të kaluara në momentin e kthimit dhe nënshkrimin e përdoruesit. Inspektorët kanë kontrolluar formularët e përdorimit ditor të mëse 62 automjeteve dhe kanë vërejtur se të gjitha automjetet përdorin formularët e tillë. Kjo performancë rrjedh nga serioziteti i përdoruesve në shfrytëzimin e automjeteve. Punonjësit policor inkurajohen të vazhdojnë të tregojnë seriozitet drejt prezantimit të informatave të plota në formularë të tillë, duke ndikuar në vendosjen e kontrollit më të rreptë të përdorimit të tyre. Kjo performancë është vazhdimësi e gjendjes së gjetur të para tre viteve, kur IPK-ja ka realizuar inspektimin e fundit.

3.2.3. Inspektorët janë interesuar të vlerësojnë gjendjen higjienike të automjeteve të inspektuara në stacione policore dhe me këtë rast kanë vlerësuar gjendjen higjienike të automjeteve zyrtare. PSO - ja për Flotën Operative ka përcaktuar se “mbikëqyrësi i secilës njësi që posedon automjete, duhet të sigurohet që ato të pastrohen në mënyrë periodike, jashtë dhe brenda, që t’i mirëmbahet pamja”. Doracaku i Parimeve dhe Procedurave në Parimin P-10.01 kur flitet për procedurën e mirëmbajtjes, në pikën 4 potencon se “policët dhe mbikëqyrësit e tyre janë personalisht përgjegjës për gjendjen e automjetit që ata drejtojnë”. Më tutje, Parimi potencon se “automjetet duhet të mirëmbahen sipas një standardi të lartë të prezantimit”. Pas kontrollimit të automjeteve zyrtare, është konstatuar se prej 62 automjeteve të inspektuara, katër prej tyre (6.5%) kanë rezultuar të papastra në aspektin higjienik, derisa 58 të tjera (93.5%) kanë qenë në gjendje të mirë higjienike. IPK-ja herën e fundit ka rekomanduar komandantët e stacioneve policore që të ushtrojnë kontrolle mbi përdoruesit, në mënyrë që automjetet të jenë të pastra në aspektin higjienik, për të pasqyruar imazh pozitiv para të tjerëve. Që nga atëherë vërehet se stacionet e kanë marrë më seriozisht këtë situatë dhe se gjendja ka ndryshuar, por duke synuar që të përmirësohet edhe më tej.

3.2.4. Bazuar në një numër inspektimesh të realizuara më parë, vazhdimisht është hasur në nevoja për automjete. IPK ka dashur të njihet përsëri me nevojat e stacioneve, ngase automjetet paraqesin një aset shumë prioritar që ndikon në efikasitetin e kryerjes së detyrave. Fokus i inspektimit në këtë drejtim ka qenë vlerësimi i fuqisë aktive apo mjeteve në funksion në periudhën që është kryer inspektimi. Gjatë inspektimit të realizuar në 16 stacione në kuadër të të gjitha drejtorive rajonale, vërehet se ato janë të ngarkuara me një numër të konsideruar automjetesh, por që në fakt vetëm një pjesë e tyre janë funksionale. Kjo nënkupton se dallon ngarkesa me automjete, me fuqinë aktive të tyre. Bazuar në të dhëna të ofruara nga stacionet policore, 16 prej tyre që kanë qenë subjekt i inspektimit kanë të evidentuara apo janë të ngarkuara me 195 automjete, por që në fakt vetëm 88 prej tyre kanë qenë në funksion. IPK-ja nuk është ndarë e kënaqur me shpërndarjen aktuale të automjeteve, por edhe me fuqinë aktive momentale të tyre. Në disa stacione është hasur gjendje e rënduar me automjete policore funksionale. Duke vënë në raport numrin e automjeteve funksionale me numrin e zyrtarëve, shihet se Prishtinë Jugu ka në dispozicion tre automjete për 172 zyrtar apo një automjet ka qenë në disponueshmëri të 57 zyrtarëve. Edhe stacionet tjera kanë një gjendje të rënduar sa i përket disponueshmërisë së automjeteve. Mesatarisht në nivel të 16 stacioneve policore pasqyrohet një raport 1:21, duke nënkuptuar se një automjet ka qenë në funksion të 21 zyrtarëve. Shqetësime rreth disponueshmërisë dhe shpërndarjes së automjeteve kanë shprehur edhe drejtuesit në stacione policore, duke vlerësuar se mungesa e tyre po pamundëson përmirësimin e objektivave dhe vështirëson punën në terren.

<b>Tabela nr. 2 - Të dhëna mbi shpërndarjen e automjeteve dhe fuqinë aktive të tyre</b>					
<b>Nr.</b>	<b>Stacioni policor</b>	<b>Ngarkesa me automjete</b>	<b>Automjete në funksion</b>	<b>Numri i zyrtarëve</b>	<b>Raporti automjet/polic</b>
1.	Prishtinë - Jugu	5	3	172	1:57
2.	Fushë Kosovë	9	4	107	1:27
3.	Ferizaj	23	8	142	1:18
4.	Kaçanik	7	3	64	1:21
5.	Gjilan	19	6	150	1:25
6.	Kamenicë	10	5	87	1:17
7.	Pejë	16	9	153	1:17
8.	Istog	7	4	84	1:21
9.	Prizren - Alfa	19	8	141	1:18
10.	Prizren - Veriu	8	3	58	1:19
11.	Mitrovicë - Jugu	13	8	130	1:16
12.	Vushtrri	14	5	118	1:24
13.	Mitrovicë - Veriu	13	4	124	1:31
14.	Leposaviq	7	7	110	1:16
15.	Gjakovë	17	6	138	1:23
16.	Malishevë	8	5	80	1:16
	<b>Gjithsej</b>	<b>195</b>	<b>88</b>	<b>1.858</b>	<b>1:21</b>

#### **Rekomandimi nr. 4**

*IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbështetëse që të analizojnë gjendjen ekzistuese në stacione policore lidhur me fuqinë aktive të automjeteve dhe të ndërmarrin veprime në drejtim të shpërndarjes adekuate për të përmbushur nevojat operacionale të stacioneve policore, në drejtim të policimit efikas.*

3.2.5. Lidhur me deklarin e defekteve, gjatë inspektimit është vërejtur të jetë evidente dukuria e faktuar në së paku 11 raste, kur mbikëqyrësit dhe përdoruesit e automjeteve policore nuk përfillin rregullat mbi mirëmbajtjen e automjeteve, gjë që bën që ato të mos gëzojnë kujdesin e duhur nga ta. Doracakun në Parimin P-10.01, kapitulli I, pika 1 përcakton se “çdo dëmtim në automjet duhet të paraqitet tek Zyrtari i logjistikës së stacionit”. Më tutje, Parimi rregullon se “Policia e logjistikës duhet ta paraqes dëmin tek Flota e automjeteve të PK-së”. Sipas Doracakut, në kapitullin E, pika 7, është përcaktuar përgjegjësia e komandantit, drejtuesit dhe Zyrtarit të logjistikës, në deklarin e defekteve në automjete duke siguruar që defektet apo problemet mekanike, të mos neglizhohen duke rrezikuar paraqitjen e defekteve tjera shtesë. IPK-ja ka identifikuar 11 raste kur automjetet zyrtare janë ngasur përkundër njohurive të zyrtarëve për nevojën e mirëmbajtjes së tyre. Defektet e identifikuar nga Njësia e Autoservisit të Flotës, të shkaktuara nga pakujdesia e përdoruesve dhe mbikëqyrësve, kanë të bëjnë me ndërruesin e shpejtësisë, kushinetat, disqet, cilindrin, jastëkët e përparmë, korpën, llamellën, motorin, siguresën e frenimit, interkullerin, por edhe me defektet si rezultat i moszbatimit të servisit të rregullt, ngasjes gjatë verës me goma të dimrit, etj. Vonesat në futjen e automjeteve në program të mirëmbajtjes për servis të rregullt apo përshkak të defekteve, më shumë kanë ardhur nga neglizhenca e përdoruesve dhe mbikëqyrësve, si dhe mosinteresimi i tyre për të mbajtur automjetet në gjendje të duhur. Kjo ka efekt negativ në trajtimin e pasurisë policore dhe ndikon negativisht në rënien e fuqisë aktive të Parkut, rritë shpenzimet përshkak të kostos shtesë të defekteve që bartin dhe rrisin kohën e punës për të eliminuar defektet.

**Rekomandimi nr. 5**

*IPK-ja u rekomandon mbikëqyrësve, zyrtarëve të mirëmbajtjes së automjeteve dhe përdoruesve të tyre që të kujdesen për gjendjen teknike të automjeteve dhe sipas nevojave t'i dërgojnë në proces të mirëmbajtjes, duke mbrojtur dhe u kujdesur për to, si asete me rëndësi operationale.*

3.2.6. Herën e fundit kur është inspektuar kjo fushë, inspektorët kanë trajtuar edhe serviset rajonale në kuadër të drejtorive rajonale. Në mes tjerash në raport është potencuar edhe ngarkimi i Njesisë së Autoservisit të Flotës Operative me servise dhe riparime që mund të kryhen në servise rajonale. Është potencuar se është e paarsyeshme të ndodhë një gjë e tillë, sepse krijon humbje kohe, ngarkon pa arsye servisinqendror me angazhime shtesë dhe krijon shpenzime të derivateve për të dorëzuar automjetin në Flotë. Është e njohur se serviset rajonale kryejnë intervenime të lehta, ngase ato nuk kanë staf të mjaftueshëm. Ka qenë praktikë në të kaluarën që ekipet e mirëmbajtjes nga Njësia e Autoservisit Qendror janë angazhuar sipas një orari të caktuar, të kryejnë aktivitete të mirëmbajtjes në servise rajonale, që nënkupton se këto servise në rajone nuk janë aktive tërë kohën në mungesë të stafit. Për të pasur sukses në funksionalizimin e plotë të serviseve rajonale, duhet të plotësohen nevojat për të ngritur kapacitetet e burimeve njerëzore, ngase Flotës Operative i mungojnë së paku 24 punonjës, përfshirë automekanikë, elektrikistë, depoistë, receptionistë dhe gomisterë. Herën e fundit IPK-ja ka rekomanduar që serviset që mund të kryhen në regjione, mos të ngarkojnë servisinqendror me aktivitete të tilla, meqë krijojnë kosto të panevojshme. Lidhur me këtë, vërehet se është lëvizur para, por jo në masën e duhur. IPK nxitë edhe më tej mbikëqyrësit, zyrtarët e mirëmbajtjes së automjeteve (MTO) dhe përdoruesit e tyre, që në rastet kur disa lloje të mirëmbajtjeve mund të kryhen në servise rajonale, të shmangin situatat e panevojshme për të mos ngarkuar servisinqendror me angazhime shtesë për mirëmbajtjen e automjeteve të tyre.

**Rekomandimi nr. 6**

*IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që në bashkëpunim me Drejtorin e Departamentit të Burimeve Njerëzore, të trajtojnë në mënyrën e duhur plotësimin e nevojave të serviseve rajonale me burime njerëzore nga fusha e mirëmbajtjes së automjeteve, në drejtim të funksionalizimit të plotë të serviseve dhe racionalizimit të shpenzimeve.*

### 3.3. Mirëmbajtja dhe kostot

3.3.1. Për të verifikuar se sa respektohen rregullat dhe procedura e mirëmbajtjes së automjeteve, janë kontrolluar kartelat e punës sipas mostrës së përcaktuar. Inspektorët janë shërbyer me rregullat dhe procedurën e mirëmbajtjes së automjeteve të rregulluar me PSO. Fokusi kryesor ka qenë të vlerësohet respektimi i rregullave e procedurave gjatë pranimit të automjeteve nga njësia kërkuese, caktimit të mekanikut, hapjes së kartelave të punës, caktimit të komisionit inspektues, evidentimit të prishjes, kontaktimit të Depos së pjesëve rezervë të Flotës Operative, nënshkrimit të Fletës së punës për rastet e dërgimit të automjeteve tek operatorët e kontraktuar, kontrollimit të automjetit nga komisioni verifikues pas kthimit nga servisi i autorizuar, konfirmimit të pranimit dhe dorëzimit të pjesëve, mbylljes së kartelës të punës dhe dorëzimit të automjetit. Mirëmbajtja e automjeteve te serviset e kontraktuara gjatë kësaj periudhe të inspektimit është e reduktuar dhe këtë më së miri e tregojnë pagesat e bëra serviseve të kontraktuara, të cilat edhe pse janë në numër të vogël, kryesisht mbulojnë shërbime të kryera për rregullimin e pjesëve të caktuara të automjeteve. Automjetet që në raste të caktuara janë dërguar në serviset e kontraktuara janë kryesisht automjete operationale të tipit Mercedes Sprinter, mirëmbajtja e të cilave kërkon aparaturë dhe njohuri të veçanta, por edhe shërbime të gdhendjes e përpunimit të pjesëve të automjeteve. Vërehet tendencë e reduktimit

të rasteve të dërgimit të automjeteve në servise të autorizuar. Riparimet tek serviset e kontraktuara janë kryer me kohë dhe sipas kushteve të kontratës. Lidhur me fazat e procesit të mirëmbajtjes, vërejtjet kryesore në inspektimin e kaluar janë fokusuar te vonesat në pranimin e automjeteve të mirëmbajtura nga njësitë që dorëzojnë automjetet. Lidhur me këtë, IPK ka dhënë edhe rekomandim për ndërmarrjen e hapave të nevojshme nga inicuesit e kërkesave për riparim. Inspektimi i realizuar tani më, konstaton se tërheqja e automjeteve të riparuar bëhet me kohë dhe vitin e fundit kësaj i ka ndihmuar edhe futja në përdorim e Sistemit PRIMs, ku në momentin e mbylljes së fletës së punës, në mënyrë elektronike përmes e-mailit njoftohet ngritësi i kërkesës së riparimi i automjetit ka përfunduar. Tërheqja me kohë e automjeteve liron Flotën nga grumbullimi i tepërt i automjeteve dhe lidhur me këtë, IPK çmon angazhimet e njërive policore.

3.3.2. Në inspektimin e kaluar, inspektorët kanë pasur mundësinë që të masin efikasitetin dhe performancën e Flotës në procesin e mirëmbajtjes së automjeteve falë Sistemit Road Base, i cili ka gjeneruar informacion të hollësishëm mbi mirëmbajtjen nga momenti i hapjes së fletave të punës deri në mbyllje të tyre. Me hyrjen në funksion të Sistemit PRIMs kjo është pamundësuar dhe nxjerrja e indikatorëve mbi efikasitetin dhe performancën vështirësohet. Kur jemi tek PRIMs, duhet qartësuar se ai vazhdon të funksionojë me disa të meta dhe mbetet imperativ funksionalizimi i tij i tërësishëm, për të siguruar evidencë të plotë. Për momentin Sistemi ka disa të meta, përfshirë: pamundësinë e nxjerrjes së raporteve lidhur me investimet në automjete ngase nuk shfaqen çmimet e pjesëve të montuara në automjet, pamundësinë e nxjerrjes së raporteve mbi kohën e qëndrimit të automjeteve në servis ngase Sistemi PRIMs nuk llogaritë kohën e kaluar nga aprovimi i sjelljes së automjetit për servisim në Flotë e deri në mbylljen e fletës së punës, pamundësinë e nxjerrjes së listës së automjeteve në pritje për mirëmbajtje. Veç tjerash, Sistemi pamundëson edhe regjistrimin e lëndëve të aksidenteve, nuk regjistron derivatet dhe në të shfaqen automjete policore të tjetërsuar. Struktura përkatëse policore duhet të sigurohet që Sistemi PRIMs të jetë funksionalizuar në masën e duhur, për të mundësuar evidencë të plotë mbi procesin e mirëmbajtjes.

#### ***Rekomandimi nr. 7***

*IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që në bashkëpunim me Drejtorin e Drejtorisë për Teknologji Informativ dhe Komunikim të identifikojnë të metat e Sistemit PRIMs dhe të angazhohen në funksionalizimin e plotë të tij, për t'iu shërbyer zyrtarëve të Flotës Operative në mënyrën e duhur, drejt disponueshmërisë së informacionit të kompletuar mbi procesin e mirëmbajtjes së automjeteve, historikun e automjeteve dhe evidencave.*

3.3.3. PSO e Flotës Operative ka përcaktuar edhe fushën e dorëzimit të pjesëve të ndërruara në Depo. Inspektorët kanë kontrolluar një numër kartelash të punës dhe kanë vërejtur se mbi kthimet e pjesëve të ndërruara mbahen evidenca në formularë standard (Pjesët e vjetra të kthyera në Depo) dhe nënshkruhen nga personeli që kthen pjesët. Për pjesët e vjetra të grumbulluara, Udhëheqësi i Flotës ka praktikuar iniciimin e punës së komisioneve të verifikimit të pjesëve të ndërruara që mund të largohen nga Depoja, si pjesë të vjetra dhe të papërdorshme. Komisionet janë mbledhë varësisht nga sasia e pjesëve të grumbulluara, duke ndarë pjesët për mbeturina, që largohen nga kompania e kontraktuar. Dorëzimi i pjesëve të ndërruara paraqet shembull të mirë të menaxhimit të Flotës, drejt shtritjes së kontrollit mbi pjesët rezervë. Kjo metodë e zbatuar zvogëlon gjasat për të lënë hapësirë për keqpërdorim eventual të menaxhimit të pjesëve. IPK-ja inkurajon menaxhmentin e Flotës që të vazhdojë me realizimin e këtyre evidencave dhe verifikimeve, drejt një menaxhimi më të mirë dhe të sigurtë të pjesëve të përdorura, si dëshmi që pjesët rezervë janë futur në përdorim.

3.3.4. Flota Operative ka në kuadër të saj Depon e pjesëve rezervë për automjete. Meqenëse ajo ka numër të madh pjesësh rezervë, inspektorët kanë inspektuar mbajtjen e evidencave, përputhjen e të dhënave të regjistrit fizik dhe atij elektronik, si dhe gjendjen faktike të Depos. Inspektorët kanë krahasuar gjendjen faktike me regjistrat fizik të hyrje - daljeve të pjesëve rezervë dhe regjistrin elektronik. Gjatë inspektimit është vërejtur se mbahen evidencat fizike dhe elektronike lidhur me pjesët rezervë, por që nga krahasimi i gjendjes faktike dhe regjistrit fizik të hyrje - daljeve me atë elektronik, ka mospërputhje në pesë raste nga një mostër prej 100 pjesëve të verifikuara nga IPK-ja<sup>4</sup>. Sipas deklaramentit të Depoistit kjo ka ardhur si rezultat i rënies së rrjetit dhe vonesës që krijohet në evidentimin e azhuruar të ndryshimeve edhe në regjistrin elektronik (PRIMS). Sipas Depoistit, ndodhë shpesh që Sistemi PRIMIS të jetë jashtë funksionit, me çrast detyrohet të kryejë evidentimin e gjendjes vetëm në regjistra fizik, deri në aktivizimin e Sistemit. IPK nxitë Depoistin që të jetë më azhur në evidentimin e njëkohshëm të lëvizjes së gjendjes së Deposë me pjesë rezervë, në mënyrë që regjistrimet të bëhen njëkohësisht në dy regjistrat: fizik dhe elektronik.


3.3.5. Gjatë inspektimit të kaluar, IPK-ja ka gjetur Flotën Operative duke shfrytëzuar Sistemin Road Base për nevoja të saj, kurse viteve të fundit ka filluar me implementimin e Sistemit PRIMIS. Ky Sistem me gjithë mangësitë, ka filluar të përdoret edhe për nevoja të Depos së pjesëve rezervë. Sipas menaxhmentit të Flotës Operative, evidenca e Sistemit PRIMIS lidhur me Depon e pjesëve rezervë ka disa dobësi që kanë për pasojë mungesën e informacionit të nevojshëm. Të metat e Sistemit PRIMIS lidhen me pamundësinë e futjes në Sistem të më shumë fletëinspektimeve për një urdhërblertje (pranimi i pjesshëm i mallit), pamundësinë e gjetjes në Sistem të datës së furnizimit për artikujë të caktuar, shpërndarjen e artikujve në shumë kategori, mundësinë e futjes së dy vin numrave të njëjtë në Sistem, etj. IPK-ja vlerëson pozitivisht përparësitë që ofron Sistemi PRIMIS, por nxitë Policinë që të deklarojë të metat e tilla tek kontraktori, i cili ka implementuar projektin, në mënyrë që Sistemi PRIMIS të mbajë apo gjenerojë informacionin e duhur lidhur me Depon dhe pjesët rezervë. Andaj, rol të rëndësishëm në këtë drejtim duhet të luajë dhe Drejtoria e Teknologjisë Informativë dhe Komunikimit.

3.3.6. Siç u potencua edhe më lartë, Parku i automjeteve të Policisë përbëhet nga një numër i madh automjeteve, që kërkojnë mirëmbajtje e që kjo përcillet me kosto të kushtueshme. Kjo kosto ndryshon nga viti në vit dhe ndikim me rëndësi në këtë kosto ka edhe mosha e tyre apo amortizimi fizik. Nga një analizë e përgjithshme e tre kategorive të shpenzimeve (gomat, pjesët dhe serviset e jashtme) në vitin 2019, Flota ka reflektuar me performancën më të mirë në tetë (8) vitet e fundit dhe kjo shihet nga tabela, që pasqyron rënien e shpenzimeve vjetore në 539.749.82 € (në vitin 2014 janë krijuar shpenzime në këto tre kategori në vlerë prej 2,004,800.63 €). Rënie e madhe e këtyre shpenzimeve vërehet sidomos në katër vitet e fundit. Nëse krahasojmë indikatorët e performancës së Flotës të viteve të fundit, shumë nga ta pasqyrojnë ngritje të ekonomizimit. Kostot e furnizimit me goma kanë shënuar rënie në vitin e fundit, që bashkë me vitin 2016 paraqet vitin me shpenzimet më të ulëta në tetë (8) vitet e fundit. Kostot e furnizimit me pjesë rezervë në vitin 2019 kanë shënuar rënie për afër 50% krahasuar me një vit më parë dhe kjo paraqet vitin me shpenzimet më të ulëta nga kjo kategori në tetë (8) vitet e fundit. Shërbimet e operatorëve të kontraktuar janë në ngritje të lehtë viteve të fundit, por krahasuar me vitet e kaluar, tani janë dhjetë deri në trembëdhjetëherë më të ulëta se në periudhën kohore 2013-2015. Duke pasur parasysh vjetërsinë e Parkut, IPK-ja çmon angazhimet e personelit të Flotës në uljen e shpenzimeve operative të mbajtjes së Parkut.

<sup>4</sup> Artikujt me nr. 22-0454-0, 6N0412249C, 1R4959857CREH, 45046-69245 dhe K2DPF.



<b>Tabela nr. 3 - Përmbledhje e shpenzimeve të mirëmbajtjes së Parkut të automjeteve</b>				
<b>Vitet</b>	<b>Kostoja e furnizimit me goma</b>	<b>Kostoja e furnizimit me pjesë rezervë</b>	<b>Kostoja e mirëmbajtjes te operatorët</b>	<b>Gjithsej</b>
2013	318,815.00	1,015,903.90	448,919.42	1,783,638.32
2014	334,489.00	1,198,499.91	471,811.72	2,004,800.63
2015	175,878.62	747,021.92	355,726.22	1,278,626.76
2016	102,993.57	409,687.18	31,365.49	544,046.24
2017	182,120.75	547,495.94	19,784.98	749,401.67
2018	218,399.80	728,427.33	24,810.00	971,637.13
2019	143,675.15	362,636.88	33,437.79	539,749.82



### 3.4. Sigurimet dhe regjistrimet

3.4.1. Inspektimet e kaluara kanë në pah se bazuar në PSO-në e Flotës Operative, përgjegjësi e Zyrës së Regjistrimeve dhe Sigurimeve ka qenë që të njoftoj njësitë policore lidhur me skadimin e regjistrimit të automjeteve. E hendikepuar përshkak të personelit të kufizuar, kjo Zyre nuk ka arritur që gjithnjë të përmbushë përcaktimet e saj dhe për rrjedhojë shumë herë edhe automjetet nuk kanë arritur të regjistrohen me kohë. Por kjo nuk ka qenë lëshim vetëm i kësaj Zyreje, por edhe i njësive policore, zyrtarët e të cilave kanë neglizhuar në kryerjen me kohë të detyrave të tyre lidhur me kontrollimet teknike. IPK kishte vlerësuar se mosnjoftimi me kohë i stacioneve policore dhe njësive tjera policore ndikon në paraqitjen e vonesave në regjistrimin me kohë të automjeteve. Me këtë rast, IPK kishte inkurajuar menaxhmentin në kryerjen e një analize mbi nevojën e shtimit të personelit në kryerjen e këtyre aktiviteteve ose shqyrtimin e ndërmarrjes së hapave drejt lirimit të ZRS-së nga kjo përgjegjësi, me kusht që përcjellja e aktiviteteve rreth skadimit të regjistrimeve të automjeteve, të bartet nën përgjegjësinë e zyrtarëve të logjistikës në kuadër të administratës së stacioneve, divizioneve dhe drejtorive policore. Gjatë këtij inspektimi, inspektorët kanë vërejtur se pas shqetësimeve të IPK-së, Flota më pas ka nxjerrë një PSO, që ka bartur disa përgjegjësi tek zyrtarët e mirëmbajtjes në njësitë dhe sektorët përkatës. Me PSO-në e Flotës Operative (DL-03, datë 22.12.2017) tani më është përcaktuar që “zyrtari përgjegjës për mbikëqyrjen e automjeteve i njësisë përkatëse shfrytëzuese është i obliguar që së paku 15 ditë para skadimit të regjistrimit të automjetit, të dorëzojë certifikatën për përfundimin e kontrollës teknike të automjetit në ZRS”. Sipas PSO-së, “ZRS-ja duhet të kujdeset që në kohën sa më të shkurtër pas pranimit të certifikatës së kontrollimit teknik, të bëjë sigurimin dhe regjistrimin e automjetit”.

3.4.2. Legjislacioni në fuqi për Siguri në Komunikacionin Rrugor përcakton se “çdo mjet motorik, traktor, çiklomotor ose mjet bashkëngjitës, i lejohet që të merr pjesë në komunikacion rrugor nëse posedon lejen e komunikacionit të vlefshme, ndërsa mjetet të cilat janë të regjistruara në Kosovë edhe librezën e mjetit”. Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 01/2018 për Regjistrimin e Mjeteve që ka rregulluar fushën e regjistrimit të automjeteve për periudhën që ka qenë objekt inspektimi, ka përcaktuar se kërkesa për vazhdimin e regjistrimit mund të bëhet tridhjetë (30) ditë para kalimit të afatit të regjistrimit të mëparshëm”. Sipas Udhëzimit, Qendra e Regjistrimit të Automjeteve është e obliguar të bëjë vazhdimin e regjistrimit të automjetit nga data e skadimit të afatit të regjistrimit. E interesuar të njihet me angazhimet për regjistrimin me kohë të automjeteve, IPK ka kontrolluar 1.000 librezat të qarkullimit të automjeteve, që përfaqëson një mostër rreth 100%. Nga 1.000 librezat të verifikuara, 400 prej tyre dëshmojnë se regjistrimet e automjeteve janë bërë me vonesë. IPK ka vërejtur se janë shumë faktorë që kanë ndikuar në krijimin e vonesave të tilla, duke filluar nga dështimi i procedurave të prokurimit që me kohë të sigurojnë kontrata me kompanitë e sigurimeve, neglizhenca e zyrtarëve të mirëmbajtjes së automjeteve për të proceduar me kohë certifikatat e kontrollit teknik, etj. Kjo performancë paraqet një dështim në përmbushjen e detyrimeve për të siguruar një park funksional e të sigurt. IPK vlerëson se duhet minimizuar mundësitë që automjetet të operojnë të paregjistruara dhe të pasiguruara.

**Rekomandimi nr. 8**

*IPK-ja i rekomandon Udhëheqësit të Flotës Operative të Drejtorisë së Logjistikës të Policisë që në bashkëpunim me Zyren e Regjistrimit dhe Sigurimeve të analizojë dhe identifikojë shkaktarët që kanë ndikuar në dështimin e përmbushjes së detyrimeve lidhur me regjistrimin dhe sigurimin me kohë të automjeteve policore, dhe varësisht nga rezultatet e analizës, të deklarojnë lëshimet e tilla duke i denoncuar pranë autoritetit përkatës.*

3.4.3. Inspektorët kanë pasur në fokus dhe verifikimin e rastësishëm të automjeteve të regjistruara me vonesë, nëse ato kanë qarkulluar në intervalin kohor përgjatë të cilit kanë qenë të paregjistruara. Përshkak të numrit të madh të rasteve të regjistrimit me vonesë të automjeteve, inspektorët kanë mostruar 180 nga gjithsej 400 raste të identifikuara. Në këtë drejtim, janë verifikuar formularët e përdorimit ditor të automjeteve dhe fakturat e derivateve, me çka ka rezultuar se nga 180 automjete të mostruara (të regjistruara me vonesë), 80 prej tyre kanë lëvizur, numër ky që mund të rezultojë edhe më i lartë nëse kontrollohet mostra e plotë prej 400 automjeteve të regjistruara me vonesë. Vonesat në regjistrimin e automjeteve kanë sjellë Policinë në situatë, kur janë paraqitur dilema, në njërin anë, që të tërhiqen automjetet nga qarkullimi duke rrezikuar përmbushjen e detyrave lidhur me mandatin ligjor, apo, në anën tjetër, të qarkullojnë përkundër skadimit të regjistrimeve duke rrezikuar që automjetet e paregjistruara të përfshihen në aksidente apo incidente. Sidoqoftë, krijimi i vonesave ka pasur për pasojë operimin e automjeteve zyrtare si të paregjistruara, që për IPK-në paraqet shkelje të rregullave të trafikut, duke pasur parasysh që vetë Policia synon të disiplinojë qytetarët për shkelje të kësaj natyre.


**Rekomandimi nr. 9**

*IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që në koordinim me Drejtorin e Logjistikës dhe Udhëheqësin e Flotës Operative të ndërmarrin veprimet e nevojshme që automjetet policore të tërhiqen nga qarkullimi në situatat kur ato janë të paregjistruara, duke mos rrezikuar që ato të operojnë pa plotësuar kriterin themelor për pjesëmarrjes në trafik rrugor.*

### 3.5. Aksidentet e trafikut me përfshirje policore

3.5.1. Një ndër objektivat e këtij inspektimi ka qenë analizimi dhe trajtimi ndër vite i përfshirjes së automjeteve policore në aksidente/incidente për periudhën kohore 2017, 2018 dhe 2019. Nisur nga fakti që faktori njeri është shkaktari kryesor i aksidenteve dhe pjesëmarrësi kryesor në sigurinë e komunikacionit, është e domosdoshme që ky faktor në kontinuitet të kontribuojë në zvogëlimin e aksidenteve. Trendi i tre viteve të fundit (2017-2019) i përfshirjes së automjeteve policore në aksidente/incidente, vlerësohet të jetë tejte shqetësues krahasuar me tre (3) vitet tjera të mëhershme (2014-2016). Sipas të dhënave nga Zyra e Aksidenteve, vazhdojnë trendet afërsisht të njëjta si në të kaluarën lidhur me përgjegjësinë në aksidente, ku afërsisht në gjysmën e tyre, përgjegjës janë vetë zyrtarët policor. Herën e fundit, IPK kishte rekomanduar ndërmarrjen e masave të nevojshme për të ngritur përgjegjësinë tek punonjësit mbi pronën policore, për të siguruar se ajo trajtohet në mënyrën e duhur. Me gjithë zotimet se do të shtohen përpjekjet për të mbikëqyrë zbatimin e këtij rekomandimi, gjendja veçse është vështirësuar, me gjithë faktin se në vitin 2019 lakorja e trendit të aksidenteve ka pësuar një rënie krahasuar me dy vite më parë. Trendi negativ i përfshirjes së automjeteve policore në aksidente/ incidente ka ardhur si rezultat i papërgjegjësisë së punonjësve policor në konsiderimin e pronës policore si një mjet i rëndësishëm i kryerjes së detyrave. Trendi negativ që ka rezultuar gjatë vitit 2017 dhe 2018, ka pasur për rrjedhojë rënien e fuqisë aktive të automjeteve, duke zvogëluar fondin e automjeteve zyrtare për punë operative, duke rritur gjasat për shtimin e shpenzimeve dhe kohës së punës që humbet për aftësimin e tyre.

Viti	Aksidente	Përgjegjësia në aksidente				Incidente	Përgjegjësia në incidente			
		Fajtor	%	Jo fajtor	%		Fajtor	%	Jo fajtor	%
2012	313	143	45.68	170	54.31	17	0	0	17	100
2013	286	144	50.34	142	49.65	31	1	3.22	30	96.77
2014	243	108	44.44	135	55.55	35	0	0	35	100
2015	244	120	49.18	124	50.81	83	0	0	83	100
2016	309	151	48.86	158	51.13	61	0	0	61	100
2017	352	172	48.86	180	51.14	52	1	1.92	51	98.08
2018	331	168	50.76	163	49.24	67	0	0	67	100
2019	264	128	48.48	136	51.52	48	0	0	48	100




**Rekomandimi nr. 10**

*IPK-ja u rekomandon edhe njëherë menaxherëve policor që të shtojnë përpjekjet në sigurimin e masave adekuate dhe ngritjen e përgjegjësisë së vartësve gjatë shfrytëzimit të automjeteve policore, duke konsideruar kujdesin ndaj automjeteve si angazhim për të ruajtur pronën policore si aset që mundëson kryerjen e detyrave operative.*

3.5.2. Aksidentet/incidentet me përfshirje të automjeteve policore duhet të raportohen brenda një afati të paraparë kohor. Rregullat përcaktojnë afatin që brenda dhjetë (10) ditëve të punës duhet të raportohet për ndodhjen e rasteve. Flota Operative më herët ka mbajtur evidenca mbi aksidentet në Road Base, tanimë dhe në PRIMs, duke përfshirë edhe ato mbi kohën e raportimit. Evidencat e nxjerra nga sistemet për periudhën 2017-2019, pasqyrojnë se numri i aksidenteve/incidenteve të raportuara me vonesë me gjithë rënien në dy vitet e fundit, vazhdon të jetë i lartë. Përveç se ky numër i konsideruar i rasteve tejkalon afatin e paraparë për raportim, shqetësuese është se janë gjetur edhe raste kur aksidentet/incidentet tejkalojnë 100 ditëshin duke mos u raportuar në Flotë.<sup>5</sup> Në vitin 2017, nga numri i përgjithshëm i aksidenteve/incidenteve me përfshirje policore, vonesë në raportimin e tyre ka pasur në 65% të rasteve, deri sa në vitin 2018-2019, kjo përqindje bie në 58%. Me gjithë trendin në rënie të numrit të raportimeve me vonesë, kjo shprehje është shndërruar në dukuri. Kjo ka ardhur nga papërgjegjësia dhe neglizhenca e zyrtarëve kompetent për raportim. IPK-ja në inspektimin e kaluar ka rekomanduar ndërmarrjen e masave drejt raportimit me kohë të rasteve. Vërehet se ka filluar një vetedijesim i punonjësve, por jo në masën e duhur.

**Tabela nr. 6 - Të dhëna mbi shkallën e raportimit të aksidenteve/incidenteve me përfshirje policore**

Indikatorët/raste	Periudha krahasimore							
	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Numri i aksidenteve dhe incidenteve	330	317	278	327	370	402	397	310
Raste të raportuara deri në 10 ditë pune	164 (50%)	128 (40%)	NA	131 (40%)	115 (31%)	142 (35%)	166 (42%)	130 (42%)
Raste të raportuara përtej 10 ditëve të punës	166 (50%)	189 (60%)	NA	196 (60%)	255 (69%)	260 (65%)	231 (58%)	180 (58%)




<sup>5</sup> Lënda nr. 04/1-04HBNL/43/2017, lënda nr. DR-3002-37-17 dhe dy (2) raste për të cilat nuk janë dërguar numrat e lëndëve, ku janë përfshirë automjetet Police 226-01 dhe Police 224-01, që i përkasin Drejtorisë së Teknologjisë Informative dhe Komunikimit.

### **Rekomandimi nr. 11**

*IPK-ja u rekomandon edhe njëherë menaxherëve dhe zyrtarëve kompetent të mirëmbajtes së automjeteve të tre niveleve të strukturës organizative policore, që të ngrisin performancën e tyre në raportimin me kohë të aksidenteve dhe incidenteve, në drejtim të ngritjes së përgjegjësisë në ruajtjen e pronës policore, ngritjes së kapaciteteve aktive të Parkut të automjeteve dhe minimizimit të tendencës për shmangie apo mosdeklarim të rasteve të ndodhura.*

3.5.3. Praktikrat tregojnë se aksidentet në komunikacion paraqiten si pasojë e një mori faktorësh. Doracaku i Parimeve dhe Procedurave të Policisë, konkretisht Parimi P-1.50 përcakton se të gjithë vozitësit janë përgjegjës për përdorimin e drejtë dhe të sigurtë të automjeteve policore. Ndërsa, Parimi P-10.01 të përgjegjësitë e vozitësit përcakton se “shoferi i automjetit të PK-së duhet gjithnjë të jetë shembull pozitiv për publikun derisa drejton automjetin e PK-së dhe t’i respektoj të gjitha rregullat e trafikut”. Gjatë trajtimit të fushës mbi përgjegjësitë e punonjësve policor të përfshirë në aksidente me automjete policore, nga Zyra e Aksidenteve janë nxjerrë dëshmi për rastet që janë vlerësuar se zyrtarët policor janë fajtorë për shkaktimin e aksidenteve. Lidhur me fajësinë, brenda dosjeve janë gjetur gjokat mbi kundërvajtjet në trafik dhe numri i tyre është 96 tiketa nga 172 raste me fajësi për vitin 2017, 80 tiketa nga 168 raste me fajësi për vitin 2018 dhe 67 tiketa nga 128 raste me fajësi për vitin 2019. Si shkaktar më të shpeshtë të aksidenteve, bazuar në tiketat e trafikut të shqiptuara ndaj zyrtarëve policor për këto tre vite, rezultojnë të jenë shkeljet e rregullave të trafikut që lidhen me nenin 41 (veprimet me mjetin motorik), nenin 53 (përshtatja e shpejtësisë) dhe nenin 52 (lëvizja prapa). Edhe pse natyra e punës së punonjësve policor është sfiduese, IPK-ja inkurajon ngasësit që gjatë ngasjes së automjeteve policore, të kenë më shumë kujdes në raport me rregullat e trafikut rrugor, duke kontribuar kështu në zvogëlimin e përfshirjes në aksidente me automjete policore, si dhe në sigurinë e përgjithshme të pjesëmarrësve në komunikacion.



3.5.4. Procedura Standarde e Operimit përcakton që në kuadër të dokumentacionit të nevojshëm për raportim të aksidenteve në komunikacion apo dëmtimeve gjatë incidenteve të automjeteve të Policisë, duhet të jetë edhe inicimi i brendshëm disiplinor nga mbikëqyrësi. Numri i përgjithshëm i aksidenteve/incidenteve me përfshirje të automjeteve policore, që dyshohet të jenë me fajësinë e punonjësve policor për tre vitet e fundit është gjithsej 469 raste. Gjatë kontrollimit të dosjeve që janë të arkivuara në kuadër të Zyrës së Aksidenteve, IPK ka hasur që për periudhën tre (3) vjeçare 2017-2019, nga 469 raste me fajësi, në 81% të tyre, dosjet nuk përmbajnë inicimin e brendshëm ndaj punonjësit të dyshuar për aksidentin/incidentin e shkaktuar. Në dy vitet e fundit (2018/2019) është përqindje shumë më e lartë e mospërfshirjes së inicimeve të brendshme disiplinore në kuadër

të dosjeve të aksidenteve, krahasuar me vitin 2017 edhe pse që të tria janë të papranueshme. IPK-ja vlerëson se mungesa e inicimit të brendshëm ndaj punonjësit mund të vjen nga neglizhenca e përgjegjësve/mbikëqyrësve, mungesës së njohurive mbi rregullat dhe procedurën e inicimit, apo edhe tendencës për të mos u marrë me rastet. Menaxhmenti i Flotës Operative duhet të sigurohet se menaxherët apo mbikëqyrësit që janë përgjegjës për kompletimin e dosjes së punonjësit të përfshirë në aksident/incident me automjete policore (të dyshuar për fajësi), si pjesë të dosjes të përfshijë dhe inicimin e brendshëm disiplinor. IPK-ja vlerëson se kjo praktikë është e dëmshme, rrezikon që prona policore të mos trajtohet në mënyrë të përgjegjshme, duke rrezikuar edhe dëmtimin e vazhdueshëm të saj.

<b>Tabela nr. 7- Të dhëna përmbledhëse mbi raportimin e incimeve të brendshme disiplinore ndaj punonjësve policor të përfshirë në aksidente/incidente</b>			
<b>Viti</b>	<b>Numri i rasteve me fajësi</b>	<b>Rastet pa incim të brendshëm disiplinor</b>	<b>Përqindja (%)</b>
2017	172	114	66.2
2018	168	148	88.1
2019	128	114	89.1

<b>Rekomandimi nr. 12</b>
<i>IPK-ja u rekomandon mbikëqyrësve të zyrtarëve policor përgjegjës të aksidenteve me automjete policore, që të sigurohen të ndërmarrin veprimet e nevojshme administrative në inicimin e rasteve të disiplinës siç përcaktojnë rregullat në fuqi, duke u kujdesur njëherit që edhe inicimet e tilla të jenë pjesë e dosjes së aksidenteve, gjithë kjo në drejtim të shtimit të kujdesit ndaj pasurisë policore.</i>

### **3.6. Kushtet teknike të automjeteve për pjesëmarrje në qarkullim**

3.6.1. Përmes këtij inspektimi, IPK ka arritur të vlerësojë edhe nivelin e pajisjes së automjeteve me pajisje përcjellëse që parashihen me Ligjin nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor, por edhe me udhëzimet administrative të Ministrisë së Infrastrukturës. Ligji nr. 05/L-088 në nenin 207 ka paraparë që “automjeti i udhëtarëve, kamioni dhe autobusi gjatë qarkullimit të tyre në trafikun rrugor duhet t’i posedojnë pajisjet rezervë dhe shtesë: poçat rezervë, kutinë e ndihmës së parë, trekëndëshin e sigurisë, pajisjen për tërheqje të mjetit në defekt, jelekun reflektues, ndërsa aparatën për fikje të zjarrit, në rastet kur përdorimi i tij parashihet me ligj. IPK ka konsultuar edhe udhëzimet administrative që ka nxjerrë ministria përgjegjëse. Udhëzimi Administrativ (MI) nr. 04/2016 në nenin 34 (Kontrollimi i pajisjeve të automjeteve) përcakton se kontrollimi i pajisjeve rezervë dhe shtesë të automjetit përfshinë: çelësin e rrotave, ngritësen mekanike ose hidraulike, gomën rezervë vetëm për atë automjet që është paraparë nga prodhuesi, aparatën e fikjes së zjarrit, trekëndëshin, ndihmën e parë, dritat rezervë dhe pajimet e dimrit - zinxhirët. Lidhur me këtë të fundit, Udhëzimi Administrativ (MI) nr. 02/2017 për pajisje dimërore, në nenin 3 (Pajisjet dimërore për automjete të udhëtarëve dhe mjeteve transportuese deri në 3.5 tona) ka përcaktuar se pajisjet dimërore për automjetet e udhëtarëve dhe mjeteve transportuese deri në 3.5 t janë: pneumatikët e dimrit në të gjitha rrotat, ose pneumatikët veror me thellësi minimale të sipërfaqës shkelëse prej 4 mm, me zinxhirët e dëborës që vendosen në rrota tërheqëse. Gjatë kontrollimit të pajisjeve rezervë dhe shtesë në 62 automjete të inspektuara, inspektorët kanë plotësuar formularët e verifikimit, të cilët janë nënshkruar edhe nga personat përgjegjës pjesëmarrës në procesin e verifikimit. Nga verifikimi ka rezultuar se ende vazhdon dukuria si herëve të kaluara që automjetet të mos jenë të pajisura në

mënyrën e duhur me pajisjet e nevojshme rezervë dhe shtesë. Inspektorët vlerësojnë se mungesa e pajisjeve operacionale ka ardhur nga neglizhenca, mungesa e kontrollit adekuat në mirëmbajtjen e automjeteve dhe mosadresimi i tyre tek menaxherët. Mungesa e pajisjeve ndikon në paraqitjen e vështirësive në marrjen e masave drejt mirëmbajtjes së duhur të automjeteve. Inspektimi vë në pah këto mungesa të pajisjeve në automjetet policore:

- tre (3) nga 62 automjete nuk kanë pasur çelës të rrotave (4.8%),
- dy (2) nga 62 automjete nuk kanë pasur ngritëse mekanike ose hidraulike (3.2%),
- një (1) nga 62 automjete nuk kanë pasur gomë rezervë (1.6%),
- pesë (5) nga 62 automjete nuk ka pasur aparat për fikje të zjarrit (8.1%),
- një (1) nga 62 automjete nuk ka pasur trekëndësh (1.6%),
- shtatë (7) nga 62 automjete nuk kanë pasur ndihmën e parë (11.3%),
- 23 nga 62 automjete nuk kanë pasur drita rezervë (37.1%),
- një (1) nga 62 automjete nuk ka pasur pneumatikë dimri (1.6%),
- dhjetë (10) nga 62 automjete nuk kanë pasur litar për tërheqje në rast defekti (16.1%), dhe
- 11 nga 62 automjete nuk kanë pasur jelekë reflektues (17.7%).

3.6.2. Ligji nr. 05/L-088 për rregullat e trafikur rrugor ka përcaktuar se çfarë dokumentesh duhet të mbajë shoferi gjatë drejtimit të mjetit. Neni 203 i Ligjit, kur i referohet dokumenteve gjatë drejtimit të mjetit, përcakton se shoferi gjatë drejtimit të mjetit duhet ti mbajë me vete (mes tjerash) edhe certifikatën e regjistrimit të automjetit, policën e sigurimit dhe raportin evropian të aksidentit. Edhe sa i përket prezencës së dokumenteve, IPK konstaton mungesa të mëdha të tyre. Mungesa e dokumenteve ka ardhur nga neglizhenca dhe mungesa e kontrollit adekuat, para dhe pas përdorimit ditor të automjeteve. Mungesa e dokumenteve ndikon në një etikë apo kulturë jo të duhur të paraqitjes policore. IPK-ja ka verifikuar prezencën e këtyre dokumenteve në inspektimin që u ka bërë 62 automjeteve. IPK-ja edhe në inspektimin e kaluar ka tërhequr vëmendjen për kontrollë të shtuar sa i përket pajimit të automjeteve policore me pajisje rezervë dhe shtesë, si dhe dokumentet e nevojshme. Lidhur me këtë, struktura policore është zotuar se do të përpiqet që të shtoj kontrollet mbi implementimin e rekomandimit. Inspektimi vë në pah mungesa të këtyre dokumenteve:

- në 34 nga 62 automjete të inspektuara nuk janë hasur certifikatat e regjistrimit (54.8%),
- në dhjetë (10) automjete nuk janë gjetur policat e sigurimit (16.1%),
- në 59 nga 62 automjete nuk janë gjetur raportet evropiane të aksidenteve (95.1%).

#### **Rekomandimi nr. 13**

*IPK-ja u rekomandon përdoruesve të automjeteve dhe mbikëqyrësve që t'i kushtojnë kujdesin e duhur pajisjes së automjeteve me pajisjet dhe dokumentet e nevojshme operacionale, me qëllim të shmangies së vështirësive në mirëmbajtjen e tyre dhe kontrollit të vazhdueshëm.*

## 4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

### 4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor në takimin përmbyllës të datës 19.01.2021, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të Veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore (original)	Plani i veprimit
1.	<i>IPK-ja u rekomandon të gjithë mbikëqyrësve, zyrtarëve të mirëmbajtjes dhe përdoruesve të automjeteve zyrtare në stacione policore, që gjithherë të ndërmarrin veprimet e nevojshme rreth deklarimit dhe procedimit të automjeteve zyrtare në procedurë të mirëmbajtjes, kur vërejnë se gjendja teknike e tyre nuk përkon me standardin e kërkuar, me qëllim të aftësisë të tyre operativ, ofrimit të sigurisë në rrugë dhe ngritjes së imazhit policor.</i>		<i>Me qëllim të realizimit të veprimeve të nevojshme rreth deklarimit dhe procedimit të automjeteve zyrtare në procedurë të mirëmbajtjes, kur identifikohet se gjendja teknike e tyre nuk përkon me standardin e kërkuar, me qëllim të aftësisë të tyre operativ, ofrimit të sigurisë në rrugë dhe ngritjes së imazhit policor, në baza javore raportohet nga zyrtarët përgjegjës lidhur me gjendjen teknike të automjeteve. Departamenti për Operacione përmes divizioneve dhe drejtorive do të kujdeset për njoftimin e mbikëqyrësve, zyrtarëve të mirëmbajtjes dhe përdoruesve të automjeteve zyrtare në stacione policore, që gjithherë të ndërmarrin veprimet e nevojshme</i>	<i>Ekipet mobile të cilat operojnë në tërë territorin e Republikës së Kosovës do të autorizohen për kryerjen e inspektimit të automjeteve në teren dhe përpilimin e raporteve për këto inspektime, gjithashtu do të formohen edhe ekipe të veçanta nga Flota Operative të cilat do kryejnë inspektime lidhur me gjendjen teknike të automjeteve</i>
2.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që në koordinim me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, të angazhohet në përmbushjen e nevojave si rezultat i politikës së zëvendësimit të automjeteve, në mënyrë që të realizohet formula që siguron optimumin e numrit të automjeteve për nevoja operative, ngase trendi aktual i furnizimit me automjete të reja zyrtare nuk garanton përtëritjen e</i>		<i>Duke parë si shume të nevojshme zëvendësimin e automjeteve kemi dhene prioritete ne investime kapitale blerjes se veturave ne vlere prej 3 milion euro, mbi 40% te buxhetiti ne investime kapitale jane te orientuara ne pertrirjen e veturave, kemi bere shitjen e disa veturave te pa përdorura me qellim qe te rritet performanca ne gjendjen reale te veturave qe jane</i>	<i>Konsiderojmë se per dy vite do te behet një përmirësim i ndjeshëm i gjendje.</i>



	<i>Parkut, por përkundrazi ngritë moshën mesatare të automjeteve.</i>		<i>aktive - funksionale në përdorim.</i>	
3.	<i>IPK-ja i rekomandon komandantëve të stacioneve policore që në bashkëpunim me zyrtarët e mirëmbajtjes, të organizojnë kontrolle të shpeshta në drejtim të sigurimit se automjetet policore përdoren dhe kontrollohen nga përdoruesit konform rregullave dhe procedurave në fuqi mbi menaxhimin e automjeteve.</i>		<i>Departamenti për Operacione përmes divizioneve dhe drejtorive, konkretisht stacioneve dhe njësisve policore do të shtohet kontrolli, e të cilat do të evidentohen përmes raportit të inspektimeve që do realizohen.</i>	<i>Menjëherë</i>
4.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbështetëse që të analizojnë gjendjen ekzistuese në stacione policore lidhur me fuqinë aktive të automjeteve dhe të ndërmarrin veprime në drejtim të shpërndarjes adekuate për të përmbushur nevojat operacionale të stacioneve policore, në drejtim të policimit efikas.</i>		<i>Ne lidhje me kete Drejtori i Pergjithshem ka themeluar nje komision i cili do te beje nje analiz te gjendjes aktuale te veturave dhe nevojat te cilat do te paraqiten varësisht nga sipërfaqja dhe pozita gjeografike qe ka.</i>	<i>Brenda vitit 2021</i>
5.	<i>IPK-ja u rekomandon mbikëqyrësve, zyrtarëve të mirëmbajtjes së automjeteve dhe përdoruesve të tyre që të kujdesen për gjendjen teknike të automjeteve dhe sipas nevojave t'i dërgojnë në proces të mirëmbajtjes, duke mbrojtur dhe u kujdesur për to, si asete me rëndësi operacionale.</i>		<i>Departamenti për Operacione në bashkëpunim me Departamentit për Shërbime Mbështetëse përmes divizioneve dhe drejtorive, do të kujdeset në implementim të këtij rekomandimi</i>	<i>Menjëherë</i>
6.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që në bashkëpunim me Drejtorin e Departamentit të Burimeve Njerëzore, të trajtojnë në mënyrën e duhur plotësimin e nevojave të serviseve rajonale me burime njerëzore nga fusha e mirëmbajtjes së automjeteve, në drejtim të funksionalizimit të plotë të serviseve dhe racionalizimit të shpenzimeve.</i>		<i>Sipas strukturës organizative i gjithë personeli mbështetës dhe teknik është i paraparë vetëm në kuadër të Flotës operative përkatësisht Drejtorisë së logjistikës dhe jo nëpër DRP sipas strukturës organizative. Prandaj ju mund ti drejtoheni menaxhmentit të lartë-Drejtorit të Përgjithshëm me kërkesën për ndryshimin e strukturës organizative e cila do ti përshtatej nevojave</i>	

			aktuale dhe do te na obligonte në plotësimin e nevojave me staf. Departamenti për Burime Njerëzore është dhe do të jetë gjithmonë i përkushtuar për plotësimin e nevojave edhe me personel. (Komenti sipas Departamentit të Burimeve Njerëzore).	
7.	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që në bashkëpunim me Drejtorin e Drejtorisë për Teknologji Informative dhe Komunikim të identifikojnë të metat e Sistemit PRIMs dhe të angazhohen në funksionalizimin e plotë të tij, për t'iu shërbyer zyrtarëve të Flotës Operative në mënyrën e duhur, drejt disponueshmërisë së informacionit të kompletuar mbi procesin e mirëmbajtjes së automjeteve, historikun e automjeteve dhe evidencave.		Nga muaj tetor i vitit 2020 kemi filluar me mbledhjen e kërkesave nga zyrtaret përgjegjës të logjistikës dhe Flotës me qëllim korrektimit të gabimeve në sistem, shtimit të funksioneve dhe rritjen e disponueshmërisë. Deri me tani në aspektin teknik të operimit të sistemit janë marre të gjitha masat e nevojshme që sistemi PRIMs të jete funksional dhe i disponueshem 24/7 dhe funksionalitetet momentale të tije të janë konforme kërkesave të zyrtareve përgjegjës. Gjithashtu, edhe në aspektin e zhvillimit dhe funksionalizimit të disa pjesëve është bere progres si ne evitimin e pengesave ashtu edhe në zgjerimin e funksionaliteteve dhe kërkesat e adresuara deri me tani për zhvillim ose korrektim të proceseve janë realizuar rreth 35% e kërkesave të adresuara që lidhen me Sektorin e flotës Operative, Zyrën e bazës së te dhënave në flote, zyrën e aksidenteve, depon e pjesëve rezerve dhe receptionin e servisit të flotës operative.	Realizimi i kërkesave tjera që janë në proces pritet të zhvillohen në 3 muajin e parë të vitit 2021. Gjithashtu, kërkesa tjera përveç atyre që janë në pritje për realizim janë të parapara dhe si drejtori e TIK-ut jemi të përkushtuar që çdo detaj në secilin modul të funksionalizohet dhe mirëmbahet në vazhdimësi në mënyrë që zyrtaret përgjegjës të jene në gjendje të realizojnë detyrat e tyre.
8.	IPK-ja i rekomandon Udhëheqësit të Flotës Operative të Drejtorisë së Logjistikës të Policisë që në bashkëpunim me Zyrën e Regjistrimit dhe		Shkaktarët që kanë ndikuar në dështimin e përmbytjes së detyrimeve lidhur me regjistrimin dhe sigurimin me kohë të automjeteve	Me qëllim të eliminimit të kësaj dukurie lidhur me regjistrimin dhe

	<i>Sigurimeve të analizojë dhe identifikojë shkaktarët që kanë ndikuar në dështimin e përmbushjes së detyrimeve lidhur me regjistrimin dhe sigurimin me kohë të automjeteve policore, dhe varësisht nga rezultatet e analizës, të deklarojnë lëshimet e tilla duke i denoncuar pranë autoritetit përkatës.</i>		<i>policore kryesisht lidhen me neglizhencën e zyrtarëve përgjegjës (MTO) për kryerjen me kohë të kontrollimeve teknike të automjeteve e në disa raste edhe mungesa e kontratave për sigurimin e automjeteve për shkak të procedurave të prokurimit.</i>	<i>sigurimin me kohë të automjeteve policore, nga zyra e regjistrimit të automjeteve është duke u aplikuar informimi tek zyrtaret kompetent përmes e-mailit lidhur me datat e skadimit të regjistrimit në baza mujore</i>
9.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që në koordinim me Drejtorin e Logjistikës dhe Udhëheqësin e Flotës Operative të ndërmarrin veprimet e nevojshme që automjetet policore të tërhiqen nga qarkullimi në situatat kur ato janë të paregjistruara, duke mos rrezikuar që ato të operojnë pa plotësuar kriterin themelor për pjesëmarrjes në trafik rrugor.</i>		<i>Do të ndërmarrim masa në këtë drejtim, do të Autorizohet Drejtori i Logjistikës që të beje implementimin e këtij rekomandimi.</i>	<i>Brenda viti 2021</i>
10.	<i>IPK-ja u rekomandon edhe njëherë menaxherëve policor që të shtojnë përpjekjet në sigurimin e masave adekuate dhe ngritjen e përgjegjësisë së vartësve gjatë shfrytëzimit të automjeteve policore, duke konsideruar kujdesin ndaj automjeteve si angazhim për të ruajtur pronën policore si aset që mundëson kryerjen e detyrave operative.</i>		<i>Departamenti për Operacione përmes divizioneve dhe drejtorive, konkretisht stacioneve dhe njësisve policore do të vazhdojë edhe më tutje në ngritjen e përgjegjësisë së vartësve gjatë shfrytëzimit të automjeteve, në çdo kohë dhe gjatë tërë vitit.</i>	<i>Menjëherë</i>
11.	<i>IPK-ja u rekomandon edhe njëherë menaxherëve dhe zyrtarëve kompetent të mirëmbajtjes së automjeteve të tre niveleve të strukturës organizative policore, që të ngrisin performancën e tyre në raportimin me kohë të aksidenteve dhe incidenteve, në drejtim të ngritjes së përgjegjësisë në</i>		<i>Me qëllim të ngritjes së performancës në raportimin me kohë të aksidenteve dhe incidenteve, në drejtim të ngritjes së përgjegjësisë në ruajtjen e pronës policore, ngritjes së kapaciteteve aktive të Parkut të automjeteve dhe minimizimit të tendencës për shmangie apo mosdeklarim të</i>	<i>Do të shpërndalet PSO e Flotës Operative të zyrtarët përgjegjës ku specifikohen afatet kohore për raportimin të rasteve të</i>

	<i>ruajtjen e pronës policore, ngritjes së kapaciteteve aktive të Parkut të automjeteve dhe minimizimit të tendencës për shmangie apo mosdeklarim të rasteve të ndodhura.</i>		<i>rasteve të ndodhura, zyrtarët e Flotës Operative do të informojnë mbikëqyrësit për rastet kur lëndët nuk janë të kompletuara ashtu si është e specifikuar në PSO-në e Flotës Operative</i>	<i>aksidenteve/incidente dhe për çdo mosrespektim të këtyre afateve do të informohen mbikëqyrësit kompetent.</i>
12.	<i>IPK-ja u rekomandon mbikëqyrësve të zyrtarëve policor përgjegjës të aksidenteve me automjete policore, që të sigurohen të ndërmarrin veprimet e nevojshme administrative në iniciimin e rasteve të disiplinës siç përcaktojnë rregullat në fuqi, duke u kujdesur njëherit që edhe iniciimet e tilla të jenë pjesë e dosjes së aksidenteve, gjithë kjo në drejtim të shtimit të kujdesit ndaj pasurisë policore.</i>		<i>Departamenti për Operacione përmes divizioneve dhe drejtorive, konkretisht stacioneve dhe njësive policore do të vazhdojë edhe më tutje në iniciimin e rasteve të disiplinës, si edhe të njëjtat të jenë pjesë e dosjes së aksidenteve.</i>	<i>Menjëherë</i>
13.	<i>IPK-ja u rekomandon përdoruesve të automjeteve dhe mbikëqyrësve që t'i kushtojnë kujdesin e duhur pajisjes së automjeteve me pajisjet dhe dokumentet e nevojshme operacionale, me qëllim të shmangies së vështirësive në mirëmbajtjen e tyre dhe kontrollit të vazhdueshëm.</i>		<i>Departamenti për Operacione në bashkëpunim me Departamentit për Shërbime Mbështetëse përmes divizioneve dhe drejtorive, do të kujdeset që automjetet policore të jenë të pajisura me dokumente të nevojshme operacionale.</i>	<i>Menjëherë</i>

Shtojca 1: Të dhëna mbi përmbushjen e rekomandimeve nga inspektimet e mëparshme				
Gjetjet nga inspektimi i mëparshëm (viti 2017)				
Inspektimi: Menaxhimi i flotës së automjeteve dhe pajisjeve policore, nr. 1/2017				
Nr.	Rekomandimi i dhënë	Komentet e strukturës policore (në origjinal)	Afatet për zbatim	Niveli i zbatimit
1.	IPK-ja u rekomandon të gjithë mbikëqyrësve, zyrtarëve të mirëmbajtjes dhe përdoruesve të automjeteve zyrtare në stacione policore, që gjithëherë të ndërmarrin veprimet e nevojshme rreth deklarimit dhe procedimit të automjeteve zyrtare në procedurë të mirëmbajtjes, kur vërejnë se gjendja teknike e tyre nuk përkon me standardin e kërkuar, me qëllim të aftësisimit të tyre operativ, ofrimit të sigurisë në rrugë dhe ngritjes së imazhit policor.	Për të evituar gjendjen e gjetur, Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse ka kërkuar raportime javore rreth gjendjes së automjeteve. Qëllimi i këtyre raporteve është që edhe mbikëqyrësit e të gjitha niveleve të jenë të njoftuar me gjendjen e automjeteve në njësitë e tyre. Si duket këto raporte nuk janë marrë seriozisht.	Menjëherë do të informohet zinxhiri komandues për ndërmarrjen e masave urgjente për eliminimin e këtyre neglizhencave. Si kontroll i përmirësimit të kësaj gjendjeje, Departamenti për Shërbime Mbështetëse do të kujdeset që të dërgoj ekipe në terren për verifikim të gjendjes dhe sipas nevojës do të ndërmerren masa disiplinore. Planifikohet që gjendja të normalizohet në mars të vitit 2018.	Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Pjesërisht</i>
2.	IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të lartë të PK-së që në planet e ardhshme strategjike të vendosin me prioritet objektiva dhe veprime që orientojnë organizatën në adresimin e çështjeve që ndihmojnë në mirë funksionimin e Parkut të automjeteve.	PK-ja vazhdimisht planifikon (Plani Strategjik Zhvillimor 2016 – 2020, objektiva 1.1) dhe i qaset problematikës me prioritet, mirëpo në mungesë të buxhetit për zëvendësim të automjeteve, çdo gjë është e kotë. Flota Operative e PK-së siç e keni vërejtur, në mungesë të buxhetit dhe për shkak të procedurave të komplikuar të prokurimit, është vjetëruar tej mase dhe ka kaluar të gjitha kriteret e	PK-ja vazhdimisht adreson gjendjen e krijuar dhe kërkon buxhet shtesë për freskimin e Flotës operative me automjete të reja. Sigurimi i buxhetit varet nga Qeveria dhe është jashtë kompetencave të	Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Pjesërisht</i>

		jetëgjatësisë. 80% e automjeteve janë më të vjetra se 7 vite dhe kanë të kaluara më tepër se 250.000 km.	PK-së. Në momentin që sigurohet buxhet, ky rekomandim implementohet.	
3.	IPK-ja i rekomandon Zyrtarët Kryesor Administrativ që të shtyjë proceset drejt tjetërsimit të kësaj pasurie, bazuar në kriteret dhe procedurat e përcaktuara me Rregulloren (MF) nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe Planin e zëvendësimit të automjeteve, për të siguruar që PK-ja të ketë një Park funksional të automjeteve, të mbështetur me fond të mjaftueshëm të automjeteve dhe të mirëmbajtur në mënyrë efikase dhe ekonomike.	Automjeti është pajisje primare e punës policore dhe mungesa e saj pamundëson arritjen e objektivave. Pamundësia e zëvendësimit me automjete të reja ka detyruar PK-në që të shfrytëzojë automjetet edhe pas kalimit të kriterëve të jetëgjatësisë. Në rastet kur automjeti shkatërrohet dhe nuk ka mundësi riparimi atëherë hyn në procedurë për tjetërsim.	Procedurat për tjetërsim kanë filluar dhe janë në proces në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike sipas vendimit të Kryeministrit.	<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <b>Plotësisht</b>
4.	IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve që të ushtrojnë kontroll më të shpeshtë mbi përdoruesit e automjeteve dhe zyrtarët kompetent të mirëmbajtjes, në mënyrë që automjetet gjatë ekspozimit në rrugë, të paraqesin imazh pozitiv para qytetarëve.	E lidhur me rekomandimin nr. 1	Rekomandimi do të përcillet për të pasur kujdes më të shtuar. Ekipet inspektuese do të kujdesen për verifikim të implementimit.	<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <b>Përgjithësisht</b>
5.	IPK-ja u rekomandon mbikëqyrësve, zyrtarëve të mirëmbajtjes së automjeteve dhe përdoruesve të tyre që të kujdesen për gjendjen teknike të automjeteve dhe sipas nevojave t'i dërgojnë në proces të mirëmbajtjes, duke mbrojtur dhe u kujdesur për to, si asete me rëndësi operationale.	E lidhur me rekomandimin nr. 1	Rekomandimi do të përcillet për të pasur kujdes më të shtuar. Ekipet inspektuese do të kujdesen për verifikim të implementimit.	<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <b>Pjesërisht</b>
6.	IPK-ja u rekomandon mbikëqyrësve, zyrtarëve të mirëmbajtjes së automjeteve dhe përdoruesve të tyre që në rastet kur disa lloje të	PK-ja ka filluar dhe është duke përfunduar projektin e decentralizimit të servisit për mirëmbajtjen e automjeteve. Pajisjet dhe	Flota operative do të kujdeset që aty ku servisi rajonal është funksional,	<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <b>I papërmëshur</b>

	mirëmbajtjeve mund të kryhen në servise rajonale, të shmangin situatat e pa nevojshme, duke ngarkuar servisin qendror me angazhime shtesë për mirëmbajtjen e automjeteve të tyre.	objektet janë të gatshme vetëm pritet rekrutimi i personelit. Po ashtu, dy ekiye mobile të Flotës, me orar vizitojnë DRP-të dhe kryejnë riparime te nevojshme.	automjetet e atij regjioni të mos vijnë në servis qendror për riparime që mund të kryhen në DRP. Planifikojmë që këto servise të funksionalizohen të gjitha deri në fund të 2018.	
7.	IPK-ja u rekomandon të gjithë menaxherëve policorë të stacioneve, drejtorive, divizioneve dhe departamenteve që të shtojnë përpjekjet e tyre në mënyrë që personeli kompetent i shërbimeve mbështetëse, të tërheqë në kohë të duhur automjetet nga procesi i mirëmbajtjes, duke mundësuar ngritjen e fuqisë aktive apo fondit të automjeteve policore në funksion.	Vërejtja në fjalë do të përcillet tek kompetentët.	Departamenti për Shërbime Mbështetëse do të kujdeset për sanksionimin e atyre që nuk respektojnë afatin e tërheqjes së automjeteve të riparuar.	<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Plotësisht</i>
8.	IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Flotës operative, Drejtorit të Logjistikës dhe Udhëheqësit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që të shqyrtojnë mundësinë në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë Informative, në ngritjen e kapaciteteve të Bazës së të dhënave, në mënyrë që të dhënat mbi mirëmbajtjen e automjeteve të jenë më të plota, duke mundësuar lehtësim në marrjen e vendimeve në interes të Parkut të automjeteve.	Nuk ka koment	PK-ja ka filluar shfrytëzimin e sistemit PRIMs për menaxhimin e personelit dhe resurseve. Deri në qershor të vitit 2018 planifikohet që të përdoret vetëm ky sistem për menaxhimin e të dhënave në Flotë.	<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>I pavlerësuar (Sistemi Road Base nuk përdoret më dhe është zëvendësuar me PRIMs, andaj ky rekomandim është i tejkaluar)</i>
9.	IPK-ja u rekomandon menaxherëve policorë që të shtojnë përpjekjet në sigurimin e masave adekuate dhe ngritjen e përgjegjësisë së vartësve gjatë shfrytëzimit të automjeteve, duke konsideruar	E lidhur me rekomandimin nr. 1	Rekomandimi do të përcillet për të pasur kujdes më të shtuar. Ekiye inspektuese do të kujdesen për	<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Pjesërisht</i>

	<i>kujdesin ndaj automjeteve si angazhim për të ruajtur pronën policore si aset që mundëson kryerjen e detyrave operative.</i>		<i>verifikim të implementimit.</i>	
10.	<i>IPK-ja u rekomandon menaxherëve dhe zyrtarëve kompetent të mirëmbajtjes së automjeteve të tri niveleve të strukturës organizative policore, që të ngrisin performancën policore në raportimin me kohë të aksidenteve dhe incidenteve, në drejtim të ngritjes së përgjegjësisë në ruajtjen e pronës policore, ngritjes së kapaciteteve aktive të Parkut të automjeteve dhe minimizimit të tendencës për shmangie apo mos deklarim të rasteve të ndodhura.</i>	<i>Nuk ka koment</i>	<i>Rekomandimi do të përcillet për të pasur kujdes më të shtuar. Ekipet inspektuese do të kujdesen për verifikim të implementimit.</i>	<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Pjesërisht</i>
11.	<i>IPK-ja u rekomandon mbikëqyrësve që të ndër marrin veprimet e nevojshme drejt disiplinimit të ngasësve policorë të automjeteve, me qëllim të ngritjes së vetëdijes policore në trajtimin si dhe shfrytëzimin e duhur të pasurisë policore.</i>	<i>E lidhur me rekomandimin nr. 9</i>	<i>Rekomandimi do të përcillet për të pasur kujdes më të shtuar. Ekipet inspektuese do të kujdesen për verifikim të implementimit.</i>	<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>I papërbushur</i>
12.	<i>IPK-ja u rekomandon përdoruesve të automjeteve dhe mbikëqyrësve që t'i kushtojnë kujdesin e duhur pajisjes së automjeteve me pajisjet dhe dokumentet e nevojshme operationale, me qëllim të shmangies së vështirësive në mirëmbajtjen e tyre dhe kontrollit të vazhdueshëm të tyre mbi validitetin e regjistrimit dhe sigurimit.</i>	<i>E lidhur me rekomandimin nr. 1</i>	<i>Rekomandimi do të përcillet për të pasur kujdes më të shtuar. Ekipet inspektuese do të kujdesen për verifikim të implementimit.</i>	<b>Vlerësimi nga IPK-ja:</b> <i>Pjesërisht</i>